

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 233, Mars 2023
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

TAKIM I PËRZEMËRT NË PRESIDENCË

2 Me datën 20 Mars 2023, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, **Zotni Bajram BEGAJ**, priti një përfaqësi të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Ditën e Hënë, më 20 Mars 2023, SH.T. Z. Bajram BEGAJ, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, priti në një takim të përzemërt një përfaqësi nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" zotërinjtë: Ndue Sanaj, Kryetar i Shoqatës; Gjergj Leqejza, N/Kryetari i Shoqatës; Agron Hasanaj, N/Kryetari i Shoqatës dhe profesor doktor Zef GJETA, anëtar i shoqatës. Fillimisht, z. Bajram Begaj, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, uroi mirëseardhjen miqve dhe tregoi se ishte i kënaqur, që në zyrën e tij priste këta miq.



DUKAGJINI KËRKON RRUGËN!

Prej disa muajsh, banorët e njërive administrative të Dukagjinit, që i përkasin Bashkisë Shkodër dhe asaj të Laçit të Vaut të Dejës janë organizuar në kryeqendrën e Veriut në një lëvizje të përbashkët me synime të drejta, progresiste dhe zhvillimore, që të nxisin...

3



MIMIKA LUCA, AKTORJA E MADHE E ME ZEMËR TË GJËRË

7

Tri ikona ka kinematografia shqiptare: Tinka Kurti, Margerita Xhepa e Mimika Luca. Tinka e Mimika janë bijë dhe nuse nga Dukagjini

Për Mimika Lucën 21 shkurti u tregua i pamëshirshëm, sepse me Uratën e Zotit e rrëmbeu, siç duket i duhej yjeve në qiell që të ndriçonin më bukur në saje të talentit të saj artistik. Ishte një bashkeshorte, një nënë, një gjyshe dhe kolege e veçante. Ajo nuk kthehet dhe zor të zëvendësohet. Me Mimikën janë krenarë jo vetëm i biri, Gjergji me bashkeshorten, ...

NË EPOSIN E KRESHNIKËVE, NË "CURRAJ EPËR", TEK NDUE DEDË ZEFI

8

Një ftesë miqësore!
Pas një darke mortore në Shkodër (vjeshtë 2022), një dorë dashamirëse më rrethon belin e më thotë: -"Sonte do të vish në shtëpinë time, për mbas darke asht lehte, po rrimë e kuvendim bashkë".

-Ti ndoshta ke harrue se në shpinë tande, në Curraj Epër, kam ardhë qysh para një gjysmë shekulli, por ti ke qillue larg në Valbonë, atje ku punoje. Ndër kohë, edhe disa të tjerë më ftojnë, një traditë e mirë e ruajtur në Malësi, kur nuk kishte as hotele, as hane; edhe sot mikpritja bujare i konkurron dukshëm.

-Sonte jam në Curraj Epër, tek Ndue Dedë Zefi,- u përgjigjem ...

NGATRRRESË ME HATËRMBETJE...

TAHIR BEZHANI,
Gjakovë, me 3 janar 2023

15

Muaj tetor kishte filluar me mot të mirë. Dielli rrezonte si në fillim pranvere. Të korrat dhe punët e verës kishin mbaruar, përgatiteshin tokat për të mbjellat vjesh-tore. Qëndrim Bregu interesohej për çdo imtësi të punëve shtëpiake; për farën, për plehun, traktorin, drutë për dimër, veshm-bathjen e të tjera. Madje ndihej më i obliguar nga të tjerët, me që ishte edhe zot shtëpie në mesin e dhjetë anëtareve të familjes Bregu.

Kishte kohë që punët e tepërta kishin filluar ta lodhnin, por durimin e gjente në thembër të këmbës. E donte mjaft vëllain, Granitin, sepse kishte kultivuar disa tipare të rralla njerëzore, bazuar në traditën dhe edukatën e familjes Bregu. Por kohëve të fundit, në vitet e pasluftës e kishte përfshirë njëllonj vetëmburrje, ...

TAKIM I PËRZEMËRT NË PRESIDENCË

Me datën 20 Mars 2023, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, Zotni Bajram BEGAJ, priti një përfaqësi të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Ditën e Hënë, më 20 Mars 2023, SH.T. Z. Bajram BEGAJ, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, priti në një takim të përzemërt një përfaqësi nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini” zotërinjtë: Ndue Sanaj, Kryetar i Shoqatës; Gjergj Leqejza, N/Kryetari i Shoqatës; Agron Hasanaj, N/Kryetari i Shoqatës dhe profesor doktor Zef GJETA, anëtar i shoqatës.

Fillimisht, z. Bajram Begaj, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, uroi mirëseardhjen miqve dhe tregoi se ishte i kënaqur, që në zyrën e tij priste këta miq.

Në vijim, fjalën e mori z. Ndue Sanaj, i cili pasi falënderoi Presidentin e Republikës, për kohën që kishte rezervuar, bëri një prezantim të veprimtarive të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në këtë rrugëtim 20 vjeçar: misionin, qëllimin, një përmbledhje e veprimtarive kryesore, duke sjellë në vëmendje disa prej veprimtarive kulturore, artistike, bashkëpunimin me organizata, institucione, individë si brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë vendit. Arritje kulmore u cilësuan përgatitje e zhvillimi i 9-t simpoziume shkencore dhe kryesisht “100 vite arsim e kulturë në Dukagjini”, e cila i tërhoqi vëmendjen; botimi periodik i gazetës “Dukagjini”, që këtë muaj del numri 233 i saj; vendosja e përmendoreve të figurave shumë të shquara të Dukagjinit: patriotit Mehmet Shpendi dhe albanologut e krijuesit të shquar Martin Camaj, e të tjera veprimtari të saj.

Po ashtu, z. Sanaj vuri në dukje marrëdhënien mjaft të mirë, që shoqata “Dukagjini” ka krijuar në vite me institucionin e Presidencës, si rezultat i së cilës janë dekoruar një sërë figurash të rëndësishme dukagjinase, si dhe vetë zona ka marrë dekoratën e lartë: “Nderi i kombit”. Në këtë kuadër, është me rëndësi vijimi i kësaj marrëdhënie të krijuar dhe pasurimi me veprimtari të tjera në vijimësi.

Nga ana e tij, Presidenti i Republikës vuri në dukje se kishte një kënaqësi të veçantë, që të priste në takim një përfaqësi nga një zonë shumë e njohur si për qëndresën historike, për memorien vetëqeverisëse, por edhe për bukuritë e papërsëritshme dhe mundësitë reale të zhvillimit të zonës së Dukagjinit në situatën e re të krijuar, kur shumë njerëz të vendit dhe të huaj kërkojnë që të njihen me Alpet Shqiptare, të bëjnë ecje nëpër rrugë e mjedise të njohura, si dhe veprimtari të tjera argëtuese. Në këtë kuadër, është me shumë rëndësi që të bëhemi të gjithë së bashku për të ndikuar në një zhvillim harmonik, të qëndrueshëm dhe fitim prurës të kësaj zone. Duke pretenduar edhe kthimin e banorëve apo pasardhësve të tyre në këto zona “perla e xhevahire” të natyrës shqiptare.

Nga të pranishmit u soll në vëmendje që Dukagjini dhe dukagjinasi, nuk duhet të përmenden vend e pa vend për gjakmarrjen apo zakone të tjera që nuk janë karakteristike e vërtete në këto zona: përkundrazi duhet të evidentojmë dhe

lartësojmë tradita dhe sjellje të mira, traditën e vetë qeverisjes, zemrën e hapur për mikun, ndihmesën që malësorët i kanë dhënë njëri-tjetrit në çdo rast që ka qenë e nevojshme dhe sidomos thënie: “Bukë e kripë e zëmër” dhe “Shtëpia e Zotit dhe e mikut”.

Po ashtu, u prezantua edhe iniciativa e marrë se fundi nga dukagjinasi që jetojnë

qytetarëve në këtë dekadë të tretë të shekullit të Ri. Rruga do të krijojë mundësinë, që banorët apo ish banorët, më punën dhe me kursimet e tyre, të krijojnë mundësinë që të zhvillohet agro-turizmi, lloje të ndryshme të turizmit malor e historik, si një mundësi reale për zhvillimin e zonës dhe për të ofruar kushte të dëshiruara për turistët vendas dhe të huaj.

dhe me historikun e trevës së Dukagjinit!

Kryetari i shoqatës atdhetare “Dukagjini”, në emër të kryesisë së saj, i dhuroi Presidentit të Republikës: Logon e shoqatës dhe një numër të librave me autorë dukagjinasi, Luigj Shyti, Prele Milani e Lazer Kodra dhe prof. Zef Gjeta, dhe me subjekt pikërisht zonën e Dukagjinit. Po ashtu, Presidenti u ftua që të ishte pjesë e festi-



në Dukagjin apo në Shkodër, por e përkrahur nga dukagjinasi kudo që janë në Shqipëri dhe në botë: kërkesën në formën e protestës paqësore si një mënyrë e përshkallëzimit të stadiit në lidhje me rehabilitimin dhe sjelljen në standard të rrugës së njohur si “Rruga ekzistuese e Dukagjinit”. Nga të gjithë të pranishmit, kërkesa për rrugën u cilësua si kërkesë mbi të cilën ecën zhvillimi i vendit, si një e drejtë e

Presidenti i Republikës u angazhua që të japë kontributin e tij në institucionet përgjegjëse në mënyrë që dukagjinasi, por edhe gjithë vizitorëve të mundshëm, t’ju krijohen kushtet normale për të lëvizur në një rrugë me parametrat e duhur.

Ishte mjaft e rëndësishme pritja e Presidentit, i cili ishte mjaft i njohur me misionin e veprimtaritë e shoqatës atdhetare “Dukagjini”, me protestat e dukagjinasi

meve të 20 vjetorit të krijimit të shoqatës atdhetare “Dukagjini”, që do të zhvillohen në fillim të verës.

Takimi ishte në një frymë shumë miqësore, të mirëkuptimit dhe dashamirësisë reciproke dhe u pa si një mundësi, që në të ardhmen të organizohen takime e veprimtari të tjera të përbashkëta.

Agron Hasanaj



DUKAGJINI KËRKON RRUGËN!



Prof. dr. Romeo Gurakuqi

Prej disa muajsh, banorët e njësjive administrative të Dukagjinit, që i përkasin Bashkisë Shkodër dhe asaj të Laçit të Vaut të Dejës janë organizuar në kryeqendrën e Veriut në një lëvizje të përbashkët me synime të drejta, progresiste dhe zhvillimore, që të nxisin autoritetet shtetërore në respektimin e të drejtave komunitare dhe kulturore, për të rindërtuar rrugët e brendshme të Alpeve, që kalojnë, njëra, përmes Pultit, Shoshit dhe Shalës drejt Thethit dhe tjetra nga Postriba për në Shllak, Cukal, Temal dhe Dushman. Dukagjini përfshin pjesën lindore dhe qendrore të Bjeshkëve të Namuna dhe nga kjo krahinë burojnë lumenjtë e Shalës dhe Kirit. Pasuritë natyrore dhe hapësira turistike e krahinës është e pamatshme. Po ashtu, ana tjetër, Shllaku është bjeshka ma e afërt me qytetin e Shkodrës, që shihet pothuajse nga të gjitha rrugicat e qytetit.

E gjithë krahinat e lartpërmendura, përfshirë edhe Nikaj Mërturin, nga pikëpamja e ndarjes administrative kishtarë bëjnë pjesë në Dioqezën e Pultit. Historia e Dukagjinit në tërësi është një histori lirie, rezistence për ruajtjen e identitetit shqiptar dhe mosnënshtrimi ndaj regjimeve shtypëse, që në fillim të shekullit XX, nga Divani i largët sulltanor u zhvendosën gradualisht në Tiranën zyrtare, fillimisht atë të bejlerëve të pandjeshëm, më pas atë të zonalëve operativë diktatorialë, për të mbërritur tek Tranzicionistët e pafamë të Epokës së Koalicionit të Korrupsionistëve.

Historia e rrugës së munguar në fakt shkon paralelisht me privimin e të drejtës komunitare për gëzimin e një njësie të përbashkët bashkiake të të gjithë krahinave të përfshira në Dioqezën e Pultit, por ne sot do të ndalemi vetëm tek pjesa e parë: rruga e munguar si askund në Shqipëri në një sipërfaqe kaq të madhe, për aq shumë banorë, për aq shumë pasuri natyrore të vendit, për një bashkësi ndaj të cilit shteti shqiptar ka dhënë garanci të veçanta ndaj Perëndimit.

E megjithatë, 32 vite nuk u kanë mjaftuar qeverive të njëpasnjëshme shqiptare të shpenzojnë dikund nga 50 deri 60 milion Euro në total, për të plotësuar detyrimin shtetëror të ndërlikohjes së brendshme rrugore të Pultit, Shoshit, Shalës me kryeqendrën e Bashkisë së vet në Shkodër, ndërkohe që ato e kanë fundosur shtetin

në borxhe për disa breza (në një raport të Bankës së Shqipërisë lexoj se Stoku i Borxhit të Jashtëm bruto të Shqipërisë shënoi shifrën 9,893.4 milionë eurosh (9.8 miliard Euro) në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2022).

Gjate kohës, që kam qenë deputet i Parlamentit të Shqipërisë disa herë ua kam kërkuar përfaqësuesve të zgjedhur të të dy krahëve politikë drejtimin e vëmendjes dhe të fondeve për zhvillimin e njëtrajtrashëm të kësaj zone të brendshme të Alpeve dhe posaçërisht për rindërtimin e rrugës nga Prekali në Kir, Mali i Shoshit, Lotaj, Breg i Lumit dhe Thethit, si një masë kompensuese dhe një kërkesë faljeje e Shqipërisë, për krahinat e persekuatuara në bllok nga diktaturat, që nuk iu ndanë këtij vendi.

Pas çdo kërkesë, përgjigjja e vetme që kam marrë ka qenë HESHTJA.

Gjatë kohës kur përgatitej, diskutohej

dhe ligjësohej buxheti i vitit 2018, në emër të Grupit Parlamentar të PD, i propozova Parlamentit, që Qarkut të Shkodrës t'i akordohej një Transfertë e Pakushtëzuar prej 40 milion Eurosh në vit, për 4 të tilla (aq sa është shifra e shpenzuar për unazën hyrëse të Tiranës prej 3 km), për të rregulluar rrjetin rrugor në Shkodrën qytet, në Dukagjin - rindërtimi i rrugës ekzistuese, Koman, Pukë dhe Fushë-Arrës, një segment në Kelmend-Tamarë-Vukël-Razëm-Fushë e Zezë.

Projekt-ligji u hodh poshtë me arrogancë nga deputetët e PS-së, por ajo që më bëri përshtypje ishte vota kundër e deputetëve qeveritarë të Qarkut të Shkodrës. Nuk e kisha hasur për ndonjë qark tjetër, asnjë rast të tillë të një sjelljeje të përkundërt me detyrimet e përfaqësuesve të deputeteve të krahëve të ndryshëm politikë kur vjen puna për interesat e bashkësisë. E pangjashme, por e regjis-

truar tanimë në analet e historisë parlamentare të Shqipërisë, edhe si përkufizim i modelit të deputetit të shtypur pa kurriz, që pilotohet nga kjo anë prej partive politike, familjare dhe klanore.

Dhe jo vetëm kaq: heshtja mbi gjendjen diskriminuese të krahinave Alpine vazhdon të jetë mbisunduese në Parlamentin e Shqipërisë dhe për banorët e Shkodrës, fushave dhe malësive të saj, nuk ka një derë ku të trokitet, mbasi figurantët jo vendimmarrës nuk mjaftojnë për të ndryshuar fytyrën e vërtetë të qeverisë. Tirana administrative, në të gjitha degët e saj, vazhdon dhunën, injorimin, shkeljen masive të të drejtave individuale dhe komunitare, ndërkohë që përfaqësuesit e qeverisë guxojnë të vijnë për të bërë foto dhe propagandë në Shkodër pa marrë asnjë përgjegjësi zgjidhjeje për banorët e vendeve ku hedhur vallen elektorale. Kjo është e papranueshme dhe e refuzueshme.

Sot, para heshtjes së pafundme të autoriteteve shtetërore, populli ka vendosur t'i dalë vete zot vendit të vet dhe njerëzve me halle shumë.

Dukagjin Deli Zot Vedit asht thirrja e dalun prej Shpirtit të Popullit, por që i ka hutuar dhe vendosur në rreshtin e paqartësisë, të pavendosmërisë, politikantëve vendore dhe qendrore, në këto ditë të pragut të fushatës krahinore zgjedhore. Nuk ka heshtje dhe fshehje më, kur vjen puna për interesa publike të një rëndësie të veçantë, që lidhen me jetën, zhvillimin, përparimin dhe gëzimin e barabartë të të mirave që ofron një shoqëri demokratike, respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut, njëtrajtrashmërinë e sjelljes së qeverisë ndaj komponentëve përbërës kulturorë të Shqipërisë.

Mirëpo, të gjithë të zgjedhurit duhet të marrin leje dikund dhe kjo leje, siç duket nuk vjen kurrë për anët tona, për Shkodrën dhe Malësitë e saja fisnike. Prandaj edhe përfaqësuesit që kanë vërshuar një mbas një këto ditë në qytet, me çanta me premtime, hallakaten pa i nda punët qartazi në lidhje me Rrugën e Dukagjinit dhe më Bashkinë e Dukagjinit. Ajo që u mbetet të bëjnë është taktika e negociimit të pambarimtë dhe paraqitja e projekteve madhështore dhe të paarritshme për mendjet e njerëzve realistë: zhvendosja e fokusit, nga ndërlikohja e Dukagjinit me Shkodrën tek ndërlikohja e Shkodrës, përmes një cepi të Dukagjinit, me Gjakovën. Krejt e papranueshme, mbasi, edhe në qoftë se bëhet, kjo rrugë nuk do të depërtojë për ndryshimin e jetës ndër cepat e pafundme të varfnisë dhe moskomunikimit në këtë zonë.

Askush nuk duhet të harrojë, se anët tona kërkojnë zgjidhje dhe jo shmangie, nuk pranojnë shtrëngim me bukën e familjeve për shkëmbime me kushte të paparimta, as përulje, as tentativa për mposhtje. Anët tona kanë Besë, Fjalë, Mikpritje dhe një Pakt që duhet të nënshkruhet tani, pa dredhi.

Kërkohet pra Besa, Fjala dhe Kontrata e Zbatueshme:

Le t'i bijme shkurt, pa hapur tunele që të çojnë në Gjakovë me



DUKAGJINI, PRESHEVA E TIRANËS ZYRTARE

Ç ka bën vëllau nuk ta bën shkja!

Dukagjin vertebra oksipitale e shqiptarizmit, përveç qenies pjesë e trungut etnik se, në gjitha aspektet e tjera është më e diskriminuar se Presheva nën çadrën Serbe. E them troç, me qetësi, me realizëm, dhimbje dhe trishtim të thellë. Kini durim dhe më ndiqni deri në fund të këtij konstatim, pastaj gjykojeni ne se jam i lajthitur apo jo?!

Në muaj nëntor udhëtove me rapso-din Gjon Kosteri dhe një grup lahutarësh, në një takim mbare kombëtare në Preshevë.

Një mik nga Presheva doli e na priti tek Dogana serbe dhe na shoqëroi me mjetin e tij, me mirësjellje e bujari tipike shqiptare. Nga perceptimi që kisha prisja të shihja ferrin me sy. Përveç faktit të një kufiri hije rendë ndarëse mes dy arterie të këputura të një trupi nuk pashe as ferr as parajsë, veç një purgator vende- vende me të bute se në Shkodër dhe gjithkund me të dhjetëra herë më butë se purgatori i Dukagjinit tim, i lindur e plakur në liri, por i keq diskriminuar nga gjithë kush ka sunduar Shqipërinë tash 110 vjet.

Ja dëgjova të gjitha brengat dhe dhimbje mikut tim patriot, që më pare pranonte terrin se diellin e Serbisë. Ne, po ikim kryeqyteteve të Evropës dhe po lëshojmë trojet. Serbi me bukë e djathë rri dhe nuk largohet, më tha me dëshpërim preshevari! Po, kishte të drejte mbasi me duar e veta shqiptarët po çojnë ujë në mulliri e serbeve. Pasi i zbrazti të gjitha brengat e hallet që duket se rendoni sa bora mbi Tomor, ndërhyra duke pyetur me kureshtje e një vizitori të pare.

Vëlla, - i them: - sa frymore shqiptare jeni?!

-Qe besa mbi 130 mije mu përgjigj! Kryetarin e komunës a është shqiptare?!

-Po ore, këtu jemi shqiptare me shumice dërmuese.

-Po administrata është serbe shqiptare?

- Bre vëlla administrata edhe policet shumica janë shqiptarë.

Desha të di për sa ishin rrogat e policëve

dhe mësova se ishin minimalisht rreth 150 vero më shumë se rroga ime!

Ka shumë vrasje në qytetin tuaj, e pyeta ndoshta pa takt?

- Jo, joooo këtu ka vite që nuk ka as një vrasje, as gjakmarrja nuk ekziston!

Të them të drejtën u xhelozova, kur

as gjë nuk më humbur!

Këtu kafshova buzën dhe fola me vete. Rast i rrallë në 365 dite të mos ketë ndonjë vjedhje, që në Shkodër qoftë edhe në një dite të mos ketë vjedhje bractare, ndërkohë që vipat me kollare i adhurohen sy yje hajdute. Nuk pashe as një rrugice të



kujtova shifrat edhe dy shifrore të vrasjeve në Shkodër locen time.

Damari kureshtarë i policit më shtyri me tej... Po vjedhjet e pickojnë Luginën tuaj?

-Nuk ekziston si problem! Unë, na thakam një dyqan riparim këpucësh dhe dytre here e sivjet e kam harruar hapur dhe

pa asfaltuar, ndërkohë që lagjet periferike të Shkodrës ngjajnë si t'lina të shejtanit të grisura nder ferra.

Mendja me fluturoi te Dukagjini im i rrudhosur mbi relievin e maleve me 607, 59 km katrorë veç 20 km asfalt të ardhur si meteor i rastësishëm vetëm dy vite me pare.

Po ashtu, Populli i Dukagjinit nga ana e vet kërkon qartazi:

1. Rindërtimin në linjën ekzistuese, të Rrugës Prekal- Kir- Mali i Shoshit- Lotaj- Bregu i Lumit - Theth, d.m.th. rrugën, që nuk mbyllet asnjë ditë të vitit, por që i jep jetë Dukagjinit, çdo fshati të tij, i hap gjerësisht mundësitë e turizmit për 365 ditë, e mban në gjallni permanente ekonominë turistike paralelisht edhe në Shkodër, ndërron tempin e ekonomisë, ristabilizon tregtinë, garanton zhvillimin e pandërprerë të sistemit të edukimit.

2. Rindërtimin e anekseve të brendshme, me radhë sipas një rreshtimi geografik:

- Guri i Mashës Kir- Pog- Plan.
- Guri i Mashës (Kir) - Xhan.
- Segmentet e brendshme në Shosh: Ndrejaj, Palaj, Brazhdë, e të tjera.
- Segmentet e brendshme në Shalë, Vuksanaj, Nicaj, Nënnavriq, Gimaj, Gag, Abat, Ndërljësë, e të tjera.

3. Rrugën për në qendër të Shllakut:

- Rruga nga Drishti në Log Gegaj;
- Koman - Benë

4. Ne fund fare, pas mbylljes së fazave të para, mund të zgjerohet edhe rruga nga Shkodra për në Prekal, që në fakt ekziston.

Prekali, nuk duhet të harrojmë, është fshati i parë i Dukagjinit. Kjo do të thotë që qeveritë shqiptare deri më tani, për 111 vite pavarësi, kanë mundësuar rrugën vetëm tek fshati i parë dhe vetëm për 6 muaj ne vit, tek fshati më verior e fundor, Thethi. Pjesa tjetër e Alpeve Qendrore Shqiptare në shekullin e XXI vazhdon të jetë në izolim të plotë rrugor, vetëm me shtegun e aksioneve të rinisë së vitit 1967.

Banorët e Dukagjinit e kanë bërë të qartë, se nuk duan asnjë shkapërdamje me projekte madhështore për ta lidhur Shkodrën me Gjakovën, duke kaluar tangencialisht në Dukagjin: Kërkohet kjo dhe thjeshtë, ndërlidhja e brendshme e 3 një-

Dukagjini im pa as një shkollë, pa as një qendër shëndetësor funksionale, pa as në qendër kulture. Dukagjini im me një popullsi të vjetër sa shkëmbi, pa as një çertifikatë pronësie për banesa, toka, kullota as pyje.

Dukagjini ndonëse me një popullsi mbi 40 mije banorë të shpërndarë si gjethet e vjeshtës, me qindra intelektual me profil të lartë ka mbi 25 vjet pas as një përfaqësim politik në Kuvendin e Shqipërisë, as në ekzekutiv, madje pot e thuash i pa përfaqësuar kurrë as deri në funksionin e n/kryetarit të Bashkisë, apo Kryetarit të Këshillit Bashkiak të Shkodrës. As serbet, as malazet disa here kallimtare të pa ftuar në malet tona, nuk kanë kryer aq vrasje sa dy tiranët tonë më të shumë kënduar Zogolli e Hoxha.

As një tremet as ekspeditë e huaj në nder malet tona nuk ka qene më rrënuese e shkatërrimtarë se epoka e dy dashnorëve tanë mëdhenj Berisha e Rama.

Dukagjini im, është viktimja më madhe e neo- otomanizmit të Tiranës zyrtare tash 110 vite.

Rruga e Dukagjinit është hapi i parë i shpëtimit të historisë e gdhendur mureve të disa qytezave qindravjeçare, i Arqipeshkvevisë më të vjetër shqiptare, i besë mbi gur, kryq e flamur.

Rruga e Dukagjini është një rilindje e shumë vonuar dhe shumë dëshiruar dhe Dukagjini nuk mund ta lëmë më nën kthetrat e bishave diskriminuese pushetarë dhe lules çudi bere të kanabisit, që pasuron të tjerët e vret Malet tona.

Larg qoftë sikur Dukagjini të mos kishte djalë as çikë, një rrugë e meritojnë, pëllumbat, thëllëzat, drenushet, derrat, dhite egra, burimet, bunet, ajri lulet dhe pyjet e atyre maleve!?

Më parë duhet pranuar të shteroi lumen e Shalës se, jetesa pa atë rrugë.

Një rrugë, që çdo qeveri njerëzore ua ka borxh qytetarëve të vetë.

Prele Milani

video dhe skema tredimensionale, veç rrugë ma të shkurtra që na lidhin shtëpitë, kullat, qendrat e banuara të njërive administrative të Dukagjinit (1/3 e Alpeve Shqiptare) me kryeqendrën e Bashkisë Shkodër.

Kërkohet rindërtimi në standard i rrugës ekzistuese, si e vetmja mënyrë për një zhvillim të gjithanshëm, tanësor dhe kapilar, siç ndodh rëndom në vendet e drejtuara në mënyrë të përgjegjshme, nga qeveri demokratike dhe europianiste, që duan zhvillim simetrik të rajoneve, të cilat administrojnë.

Krejt e thjeshtë:

Shkodra kërkon pjesën e saj, aq sa i takon nga buxheti i shtetit, për zhvillimin e zonave të veta të brendshme dhe një kompensim të arsyeshëm për mungesën disavjeçare të qeverisë qendrore ndër anët tona. Për pyetjet e Shkodrës kërkohen përgjigje të sakta, kontrata të shkrueme dhe fillim pune tani.

sive administrative të Bashkisë Shkodër dhe e një njësie administrative të Bashkisë së Vaut të Dejës.

(Në kuadrin e rindarjes administrative të Shqipërisë, me krijimin e Bashkisë së Dukagjinit, Njësia Administrative Shllak dhe ajo e Nikaj Mërtur do të duhet t'i kalojë Bashkisë së re).

Si shenjë e vullnetit të mirë, e seriozitetit dhe e angazhimit të njimendte të autoriteteve qendrore do të kishte qenë lëvrimi i menjëhershëm nga ana e Bordit të Zhvillimit Rajonal i fondeve për projektin ekzistues të Bashkisë Shkodër të segmentit Prekal-Kir-Mali i Shoshit, i cili është ndërprerë pa asnjë shpjegim nga ana e qeverisë.

Rrugët duhet t'i parapraprijnë ndarjes së re administrative për t'i mundësuar më pas autoriteteve të reja të zgjedhura, vepërimitarinë.

Shkodër, me, 24 mars 2023

DUKAGJINI PËRSËRI I COPËTUAR


Zgjedhjet vendore janë në prag, Dukagjini pa atë që i takon. Kjo jo se them unë apo ne. Por është një realitet i padiskutueshëm. Trevë, me një histori, që ka lënë gjurmë. Copëtimi saj ka filluar herët dhe atë që nuk ia bëri, Turqia, Serbo-Malazet, ia bëri sistemi komunist. Ashtu siç veproi me të gjitha krahinat e njohura e me tradita, këtë ia bëri edhe Dukagjinit. Pavarësisht se, kjo përjetoi, shtypjen, persekuacionin më të egër, jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Po të llogarisim, vrasjet, burgoset, internimet e diskriminimet, për numër të popullsisë janë më të lartat në Shqipëri, madje edhe në Ballkan e më gjere. Katër vite pas çlirimit filloi copëtimin e kësaj treve. Për të organizuar rrethin e Tropojës, Dukagjinit i heq gjysmën e zemrës, Nikaj-Mercurin. Jo vetëm kaq, por menjëherë i heq edhe Shllakun e Temalin, duke e tkurrur nga në tre krahina.

Le të kthehemi pas në histori.

Dukagjini e meriton të ishte një zone administrative - territoriale më vete. Ka një territor me sipërfaqe prej 609 km² ose mbi 2 për qind të gjithë Shqipërisë, me një reliev të thyer përfshirë Alpet qendrore me resurse të mëdha. Kjo zonë nuk mund të humbas etnografinë, historiografinë, traditën, emrin dhe kulturën e trashëguar ndër shekuj. Nga studimet arkeologjike rezultojnë, se Dukagjini, ka katër qyteza, tre kështjella të lashta. Në historikun e tij në shekuj, rezultojnë administrim më vete, me cilësi zonë autonome. Nënprefekturë, rreth e lokalitet dhe sot nuk mund të "fshihet" nga harta e Shqipërisë. Dukagjini si çdo popull tjetër, me një popullsi prej rreth 40000 banor, ka të drejtë dhe meriton të qeverisë dhe të administrojë vetveten. Kjo e mbështetur në Kush-tetutën e Shqipërisë. Dukagjini u "fshi" e nuk duhej "fshirë" nga harta gjeopolitike-administrative e Republikës Shqipërisë. Kjo konfirmohet përmes përfaqësuesve legjitim të popullit të Dukagjinit. Mendja shpesh herë, të shkon edhe mbrapsht, se nuk është rastësi kur Dukagjini është persekutuar nga regjimi totalitar. Edhe sot bijtë e tyre vijojnë të njëjtën urrejtje si të etërve të tyre. Kjo u vërtetua me reformën territoriale, e cila nuk e organizoi në bashki.

Dukagjini i pushkës e pendës nuk ka si të humbë identitetin, se për virtytet e larta në mbrojtjen e tyre janë bërë dhjetëra e dhjetëra luftëra, duke derdhur gjak e vetëm të mbrojnë identitetin, traditat, zor se i gjen në ndonjë zonë tjetër. Për të cilat kanë shkruar historian vendas e të huaj shekuj, më pare. Nuk po ndalem te betejat e zhvilluara, trimëritë e trimat që kanë dhënë jetën për mbrojtjen trojeve të lënë trashëgim prej të parëve, se do duheshin me dhjetëra e dhjetëra volume me libra. Po nuk janë vetëm të pushkës, po bijtë e bijat Dukagjinase, kanë bërë emër edhe në art e kulturë. Dukagjini është i Martin Camaj, Ernest Koliqit, Benardin Palajt, Ndoc Nikajt, Lin Delisë, Freder-

ik Rreshpes, Pjeter Gjakës, Tinka Kurtit, Zef Shoshit, Lec Shllakut, Guljem Radojës, Zef Malës, Ndreç Lucës, Profesori Kol Prelës, Daniel Gjeçajt e qindra të tjerëve. Dukagjini, është edhe i sportistëve, të cilët i kanë dhënë tonin sportit në Shkodër e në të gjithë Shq-



përinë, që mund të përmendim: Pal Mirashin, Lin Shllakun, Simon Dedën, Dod Tahirin, Prek Gjelošin, Agostin Kolën, Mirash Vuksanin, Armir Grimën, Ndue Njemzen, Vera e Ded Bregun e dhjetëra e dhjetëra të tjerë, për këto e mijëra vlera të tjera. Rap-sodët në këngë tyre thonë: Se po ti heqësh Shkodrën Dukagjinit, është një lloje si ti heqësh diellit shkëlqimin. Dukagjini e dukagjinasi janë një etni që nuk durojnë skllavërinë aq më tepër padrejtësitë. Përhëndes Shoqatën Atdhetare të Dukagjinit "Nderi i Kombit", gazetën "Dukagjini" e veçanërisht kryetarin e saj, z. Ndue Sanaj, si dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij. Këngëtarët e kësaj krahine të cilët me realizëm kanë ngritur në pedestal vlerat e kësaj

zone. Pra, të mobilizohemi të gjithë, për të kërkuar të drejtat tona, siç i kanë zona të tjera në Shqipëri.

Ne nuk duhet të pajtohemi me të keqen. Po të kërkojmë të jemi të barabartë me zonat tjera të vendit. Nuk ka njësi administrative, të cilat të mos jenë

gjitha për paraardhësit tonë të cilët luftuan, dogjën sarajet, vranë Xhon turqit dhe pushtuesit e tjerë. Le të bëhet një referendum vetëm në këto njësi administrative se, kush është dakord për ngritjen dhe bashkimin në një Bashki të vetme. Le të qëndrojmë kokë lartë, siç kanë pas tradite dukagjinasi. Të mos shitemi për një thes miell apo për një zog thiu. Votën mos ta shesim as për 100 apo 200 ero dhe as për sado të jepet. Të cilat i japin oligarkët, për të përfuturara pa drejtësisht nga taksat tona.

Të gjithë jemi në dijeni, se ata insistojnë për të blerë votën. Nesër të përfitojnë, duke marrë tenderë pa konkurrence, madje edhe ato të ashtu quajtura tenderë sekret. Blerja dhe shitja e votës është krim dhe dënohet me ligj. Tek ne nuk ka zbatim ligji, por zbatohet Maliqi.

Dukagjini ka me qindra e qindra intelektual të zot për të drejtuar një shtet. Postet e tyre, në strukturat qendrore po thuajse janë fare minimale, edhe në ato lokale janë të papërfillshme. Ne duhet të duam e të respektojmë vetveten e pastaj të tjerët. Në të kundërtën mbesim vasal të tjerëve.

Po të hedhim një vështrim te komshiu tonë e konkretisht me Melësin e Madhe, Tropojën dhe Pukën. Nuk ka asnjë qendër të njësisive administrative të pa lidhur me asfalt. Ndërsa në pesë njësit administrative të Dukagjinit nuk bëhet fjalë as për rrugë me kalldrëm. Investimet tash 10 vjet janë përquarduar kryesisht në jug. Si në çdo periudhë parazgjedhore, fillojnë investime, gjoja po na dhatë votën do i përfundojmë. Kjo tani është kuptuar se është vetëm një rrenë elektorale.

Votoni për kandidatët, të cilët janë serioz të pa korruptuar e të inkriminuar. Mjaft me kriminel e trafikant, oligark në drejtim apo rreth tyre!

Përgatiti NDUE ZIÇI



Si e sheh amerikani Klej Zezakaj Shqipërinë!

Gjate rrugëttimeve tona na rastis që të njohim njerëz me perceptime të ndryshme për imazhin e Shqipërisë, e për hir të së vërtetës nuk është se imazhi i vendit tonë ka qenë ai më i miri sidomos në vendet e zhvilluara të Perëndimit.

Jam përpjekur gjithmonë të njoh njerëz, që e duan vendin tone, por mbi të gjithë që e njohin vendin tone dhe një nga sfidat më të mëdha është kur gjen njerëz që nuk e pëlqejnë dhe ti të përpiqesh t'i tregosh më të mirën e Shqipërisë tënde.

Gjatë udhëtimit tim të fundit, në Amerikë kur po pyesja bashkësinë Shqiptare atje, se me cilin personazh ia vlen të bashkëbisedosh, pjesa më e madhe tyre më thane, për një djalë të quajtur Clayvion Winn (Klej Zezakaj, por do flasim më vonë edhe për historinë e emrit të tij të shqipëruar)!

Gjithë historinë me Shqipërinë dhe Shqiptaret e ka filluar që në gjimnaz, kur si një adoleshent i ka bërë përshtypje bukuria e vajzave Shqiptare, por duke ditur imazhin nuk i është afruar.

Më tej, në kolegji, në bibliotekë ka dëgjuar të flasin Shqip dhe me dëshirën për t'ju afruar grupit ka kërkuar në internet dhe fjala e parë që ka mësuar në Shqip, që ka qenë 'Tungjatjeta', më pas edhe fjalët bazike përsëritëse të tjera.

Një nga përshtypjet më të mëdha, në momentin që është shoqëruar me shqiptaret ka qenë kur ka mësuar për historinë, për faktin se Shqipëria ka luftuar me Serbinë, me Turqinë për shumë vite, dekada e shekuj edhe e ka ruajtur identitetin, sidomos në zonat e Malësisë dhe Dukagjinit, kur ka qenë pothuajse e pamundur të ta linin pushtuesin të hynte në territor, të tjetërsonte kulturën dhe traditat tona.

Është çuditur nga heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti si dhe fakti që monumenti i tij ndodhet në qendrat më të mëdha të Evropës dhe në një shesh në Amerikë!

Gjate bashkëbisedimit me Klej shprehet disa here që e ka pasur shumë të vështirë të hynte në grupin e Shqiptareve t'i bindte ata se donte të ishte një mik i vërtetë dhe jo diçka tjetër si armik, për këtë përmend edhe një rast konfliktual, kur ka qenë me flamurin e Shqiptar të hedhur në krahë dhe një Shqiptar i është afruar, duke i thanë ta heqë, sepse nuk po e trajton siç duhet, edhe Klej i është përgjigjur se, nuk po e hedh në tokë, nuk po djeg, por po e nderoj, sepse mendoj se është një nder flamujt më të bukur që ka bota.

Por, në momentin që ka hyrë në zemrat e tyre, është dashuruar me kulturën, me faktin që janë shumë të orientuar nga familja, duke pasur parasysh se nuk është më aq tradicionale me ndryshimin e kohës, vlerëson mikpritjen dhe



dashamirësinë. Madje përmend edhe një moment kur ka qenë në stacion të trenit dhe një Shqiptar i dha gjysmën e sandviçit të vet, për ta ndarë me atë.

Një nga gjetet më sublimë edhe emocionohet kur e flet, është kur zhvendoset për të parë në New York dhe një miku i tij Shqiptar i ka ofruar shtëpi pa qira deri sa të stabilizohet dhe i ka gjetur edhe punë.

Në këto vlerësime përmend edhe artistet e saj të thjeshtë që janë dhe se vlerësojnë mbështetjen që ai i jep për Shqipërinë, si Sinan Hoxha, Nikollë Nikprelaj, Meda, Ledri Vula, Kida, Dafina Zeqiri e të tjerë.

Një nga pjesët më zbavitëse të Shqipërisë, që i ka pëlqyer më shumë, është dasma Shqiptare dhe mënyra sesi i festojmë me muzikë dhe si e fillojmë festimet një jave përpara, aty ka mësuar edhe te këndojë Shqip.

Por famën më të madhe Klej, në bashkësinë Shqiptare e mori, kur u bë pjesë e paradës së përvitshme në Manhattan të Shqiptareve dhe video e tij u shpërnda në çdo rrjet social.

E quajtm Klej, por emri i tij i vërtetë është Clayvion Winn e ndërsa emri i Shqipëruar është Klej Zezakaj! Arsyeja, pse ka vendosur këtë emër, është sepse emri i parë shqipërohet ashtu si në Anglisht, por me shkronja Shqiptare; ndërsa mbiemri Zezakaj është ngjyrë, ashtu si zakonisht në zhargonin e përditshëm quhen njerëzit me ngjyrë dhe nuk është ofenduar aspak, sepse për të sidomos në Shqip është identitet edhe pse shpesh herë i ndjen ndryshimet raciale, por kjo me individë të veçantë, jo të gjithë.

Klej shprehet se dashurinë për Shqipërinë e përcjell kudo, edhe aty ku dëgjon të flitet keq për Shqiptaret, ndërhy duke iu thënë dëgjoni se, janë ndryshe, janë të mirë, jo ashtu siç thonë ju, madje këtë dashuri ia ka ushqyer edhe familjes së tij.

Kur e pyesim Klej se, cilat janë disa nga karakteristikat që do të veçonte tek djemtë dhe vajzat Shqiptare, ai përgjigjet: Te vajzat vlerëson shumë, se ato vlerësojnë nderin të parin dhe për to primare dhe kryesore është të mos zhgënjnë familjet e tyre; ndërsa për djemtë thotë, se për djemtë nuk ka dëgjuar fjalë shumë të mira, por ka djem vërtetë të mirë Shqiptare.

Ndera presa i përket këshillave që ju jep Shqiptareve, është të jenë më të duruar, më të shtruar dhe të mos nervozohen menjëherë.

Në përmbyllje mesazhi, që jep për Dukagjinin dhe gazetën "Dukagjini" është: "Uroj që Dukagjini të jetojë gjithmonë prej gazetës së saj, por edhe sepse janë njerëzit më punëtorë që kam njohur gjatë gjithë jetës time.

Faleminderit shumë, që më keni zgjedhur për këtë bashkëbisedim dhe uroj që gjithmonë të jeni më të mirë, duke premtuar se do vizitoje shumë shpejt Dukagjinin dhe Malësinë.

Klodjana Serraj

MIMIKA LUCA, AKTORJA E MADHE E ME ZEMËR TË GJËRË

Tri ikona ka kinematografia shqiptare:
Tinka Kurti, Margerita Xhepa e Mimika Luca.
Tinka e Mimika janë bijë dhe nuse nga Dukagjini

Për Mimika Lucën 21 shkurti u tregua i pamëshirshëm, sepse me Uratën e Zotit e rrëmbeu, siç duket i duhej yjeve në qiell që të ndriçonin më bukur në saje të talentit të saj artistik. Ishte një bashkëshorte, një nënë, një gjyshe dhe kolege e veçante. Ajo nuk kthehet dhe zor të zëvendësohet. Me Mimikën janë krenarë jo vetëm i biri, Gjergji me bashkëshorten, vajza e saj Rozafa dhe nipi i vogël Ndreka, por dhe i gjithë rrethi familjar, të afërmit dhe bashkësia artistike e më gjerë. Duke pasur afërsi me familjen e tyre, më ka takuar të bisedoj gjatë me Mimikën. Thua se çdo bisedë e kalonim në sitën e humorit, ku në këtë zhanër ajo ishte e spikatur. Me fjalën e saj të bënte për vete, shpirti i saj artistik shtrihej përtej skenës dhe ekranit, një nënë e nivelit superior, zemërgjerësia dhe bamirësia ishin virtyte, të cilat e shoqëruan gjatë gjithë jetës.

Me plot gojën duhet thënë se, ajo vijimisht shpërndante ilaçe falas për njerëzit. Vlerësoja tek ajo faktin që dinte ti përshatej çdo bashkëbiseduesi pavarësisht nga mosha, gjinia, niveli apo personaliteti. Më ka mbetur në mendje një bisedë, duke vlerësuar traditat tek unë tek po mburresha për origjinën dukagjinase të Ndrekes dhe timen, duke treguar një farë superioriteti mbi origjinën e saj, gjithmonë sipas kodit tradicional. Unë i fola për fiset më në zë, duke i rreshtuar: Frashënlite e Përmetit, Tophanën e Shkodrës, Hotin e Grudën, Dukagjinin dhe Mirditën. Ajo me shumë delikatese mu drejtua:

-Cili nga këto fise ka nxjerre figura më të spikatura në fushën e letrave shqipe? Unë menjëherë ju përgjigja për Frashënlite e Përmetit. Ndërkohe ajo me delikatesën e humorit më tha se unë sipas këtij kodi dal dy herë e fituar mbasi nëna ime Maja është mbesa e Sami Frashërit, unë pa menduar më parë pësova autogol.

HISTORIA E DHIMBSHME E FAMILJES SË MIMIKËS

Familja e nënës së Mimikës ka jetuar në mes Janinës dhe Gjirokastrës. Bashkëshorti i saj ishte një avokat shumë i njohur dhe me pasuri, por i larguar para kohe nga jeta. Ajo mbeti e vetme në Janinë, duke u detyruar të lërë vilën me 10 dynym tokë (e cila sot shërben si insti-

tucion shtetëror në Janinë), dhe niset tek të afërmit në Gjirokastrë. Por për shkak të luftës Italo-Greke ajo sipas ligjit të kohës mori në pasaportë vulën e dëbimit nga shteti grek, pa të drejtë rikthimi. Me të mbërritur në Gjirokastrë ndodhi e pamenduara. Shtëpia nuk kishte as themelet, e bombarduar nga lufta. Duke mbetur në qiell të hapur pa asnjë mjet jetese, nisen



Mimika, Gjergji, Ndreka, Rozafa

drejt Tiranës. Rrethi miqësor i familjes Frashëri, me familjen e Toptanëve bën që Murati (Toptani) të ndërhynte tek Qazim Mulleti, i cili i strehoi tek "Streha Vorfënore e Nënës Mbretëreshë". Duke marrë shkas ndoshta nga kjo ngjarje dhe mënyra se si më vonë deformatë figura e Qazim Mulletit, nënë Maja e përbuzte artin socialist, duke e quajtur falsitet i realizmit socialist, tregonte Mimika. Ndërkohë që nënë Maja ishte e punësuar në këtë institucion, Mimika po rritej për mrekulli nën kujdesin e saj. Qëndrimi në këtë strehë zgjati deri pas luftës, ndërkohë që siguruan një shtëpi banimi të veten. Mimika tregonte se teatrin e kishte pikë të dobët. Fillimi ishte si soliste, ndërsa nga viti

1951-1962 spikati si balerin me talentin dhe aftësitë e mëdha fizike. Pa menduar, rastësisht zëvendëson një aktore, por rastësia për të solli mrekullinë, tregonte regjisori, në interpretimin e rolit të rastësishëm ajo shkëlqeu në një shfaqje në Korçë. Ajo njëkohësisht interpretonte si balerinë në skenën e Teatrit Opera e Baletit. Njohja me aktorin e madh Ndreka Luca erdhi si me dorën e shenjtë që në moshë të re. Mbi gjithçka çmonte tek Ndreka personalitetin, burrërinë dhe interpretimin brilant në skenë. Talentin e tij e vlerësoi një delegacion Italian duke e quajtur një Jago të veçantë. Madhështia e tij thoshte Mimika më shoqëroi gjithë jetën.

Mimika lindi më 24 Dhjetor 1937 në Gjirokastrë. Interpretoi në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit si balerinë për 10 vite. Ka interpretuar në 33 role, ka luajtur edhe në 12 filma artistik. Ajo cilësohet si një aktore shumë dimensionale sikundër në teatër po ashtu edhe në kinematografi. veçori e saj dalluese ishte sepse luante rolet e buta me karakter të fortë duke i dhuruar skenës dhe ekranit shikueshmëri.

ROLET E INTERPRETUARA

Filloi si aktore në teatër në vitin 1962 me dramën "Rrëshqitja" të Besim Levonjës. Në dramaturgji interpretimin më të arritur e pati në rolin e Lajës tek drama "Lulet e Shegës".

Dila tek drama "Cuca e Maleve". Nica tek drama "Gjenerali I ushtrisë së vdekur". Laja tek drama "Kur hidheshin themelet". Sonja tek drama "xhaxha Vanja". Lucia tek drama "Borgjezi Fisnik". Tjen Ny tek drama "Muri i madh". Interpretimin më brilant e pati tek drama "Drita" dramë, të cilën e pati shkruar vetë në vitin 1968, e cila pati një jetëgjatësi të madhe skenike.

Mimika në teatër pati një kryerol. Ishte motra Lajde e Dajë Zenos dhe nëna e djalit Albër me doktoraturë shkencore në fizikë.

Në këtë lamije ajo mbeti një aktore shumë dimensionale, duke shkruar edhe disa drama, të cilat u shënuan nga Teatri Popullor, duke veçuar dramën "Drita"

NE KINEMATOGRAFI

• Në vitin 1963 interpretoi tek filmi "Detyrë e posaçme"(rol episodik), në



Mark Bobnaj e Gjergji Luca

këtë film luajti për herë të parë me bashkëshortin e saj Ndreka Luca.

- Në vitin 1972 tek filmi "Kryengritja në pallat".
- Në vitin 1978 tek filmi "Yje mbi Drin".
- Në vitin 1978 tek filmi "Kur hidheshin themelet" (film televiziv).
- Në vitin 1979 tek filmi "Çeta e vogël".
- Në vitin 1979 tek filmi "Në shtëpinë tonë", në të cilin spikat në rolin e Florës, nënës së Mirit, dhe gruaja e shoferit Stefi Petro.
- Në vitin 1981 tek filmi "Shoku ynë Tili" në rolin e mësueses.
- Në vitin 1983 tek filmi "Zambakët e bardhë" në rolin e Dritës, sekretarja e partisë.
- Në vitin 1984 tek filmi "Nxënësit e klasës sime" ku interpreton drejtoreshën e gjimnazit.
- Në vitin 1984 tek filmi "Taulanti kërkon një motër" në rolin e edukatores me regjisore Xhenfize Kekon.
- Në vitin 1984 tek filmi "Shi në plazh" në rolin e nënës së Albertit.
- Në vitin 1985 tek filmi "Të shoh në sy".
- Në vitin 1986 tek filmi "Viktimat e Tivarit".
- Në vitin 1986 tek filmi "Rrethimi i vogël" në rolin e Shegës, sanitarja e pallatit të kulturës e cila si kishte punët mirë me drejtorin.
- Në vitin 1987 tek filmi "Botë e padukshme" në rolin e Lenit, bashkëshortja e Iliazit.
- Në vitin 1988 tek filmi "Përrallë nga e kaluara" në rolin e nënës së Maringos.
- Në vitin 1988 tek filmi "Treni nisat në shtatë pa pesë" në rolin e nënës së Etlevës.

Për interpretimet e saj plot kolorit është nderuar nga institucione më të larta, të vendit me urdhra dhe medalje të ndryshme, por nderimi më i lartë ka qenë ai i spektatorit të të gjitha moshave.

Në vitin 1977 Mimika Luca është pedagoge në Institutin e Lartë të Arteve (sot Universiteti i Arteve), në degën e dramës por pa "tradhtuar" kinematografinë deri në daljen e saj në pension.

NDIKIMI I PRINDËRVE

NË FORMIMIN E GJERGJ LUCËS

Edukimi prindëror është themeli i formimit dhe i mbarëvajtjes së çdo fëmije. Në këtë lamije Gjergji kishte lindur me "këmishë". Qysh i vogël ka luajtur në disa filma e duke veçuar interpretimin tek filmi "Flaka e maleve" dhe më pas e kemi edhe si regjisor. Ndreka e Mimika e mishëruan me dije dhe dashuri djalin e tyre për punën me veprime deri në kufijtë e fantazisë. Sapo mbaron gjimnazin fil-

Në Eposin e Kreshnikëve, në “Curraj Epër”, tek Ndue Dedë Zefi



Frrok Vukaj

Një ftesë miqësore!

Pas një darke mortore në Shkodër (vjeshtë 2022), një dorë dashamirëse më rrethon belin e më thotë: -“Sonte do të vish në shtëpinë time, për mbas darke asht lehte, po rrimë e kuvendim bashkë”.

-Ti ndoshta ke harrue se në shpinë tande, në Curraj Epër, kam ardhë qysh para një gjysmë shekulli, por ti ke qil-lue larg në Valbonë, atje ku punoje. Ndër kohë, edhe disa të tjerë më ftojnë, një traditë e mirë e ruajtur në Malësi, kur nuk kishte as hotele, as hane; edhe sot mikpritja bujare i konkurren dukshëm.

-Sonte jam në Curraj Epër, tek Ndue Dedë Zefi,- u përgjigjem dora-dorës.

-Paske ditë me zgjedhë, nuk kënkie në të hupun, po na jet marak me ardhë me ju e të tjera, batuta na shoqëruan deri në ndarjen me bashkëbiseduesit.

Në atë copë rrugë jo fort të gjatë, por me hap të ngadaltë, për të mos prishur emocionin e bisedës, unë kalova si nëpër

një filtër a ekran, atë natë të para shumë kohëve në shtëpinë e të atit ...

Në këtë natë, ndonëse po afronte mesnata, e zonja shtëpisë (Zoja) dhe e mbesa, Rilinda, nuk kishin fjetur. Në ato biseda të çiltra e të ngrohta të asaj nate e ato ta mëngjesit tjetër, rikujtova e kthjellova shumë gjëra, që ishin mjegulluar nga vitet e gjata.

Përveç të tjerave, u gëzova pa masë, kur gjeta libra në tavolinë e përballë pashë bibliotekën, ku shquheshin edhe disa botime nga “Visaret e kombit”, ‘Eposi i kreshnikëve’ e ribotime françeskane të vitit 2017, për të cilat do të flas më poshtë.

Ndue Dedë Zefin e njoh prej më se 50 viteve. Afërsisht jemi të një brezi e moshë i lidhë e miqëson njerëzit. Largësia relative, nuk ka qenë pengesë, madje na rriti dëshirën për takime të reja. Lidhjet e miqësitë mes fshatrave e më vonë, kur u krijua kooperativa bujqësore, i shtuan edhe takimet tona.

Një urë tjetër lidhëse mes nesh pati qenë edhe nipi im, Martin Coli, me të cilin Ndou u rrit, me ato peripecitë që ka moshë, fshati e vetë rrjedha e jetës.

Edhe familjet e tyre, qysh me Kolë Lekën e Dedë Zefin, madje edhe më herët, kishin pasur (e kanë edhe sot) lidhje të ndërsjella mbi baza të shëndosha, krahu njëri-tjetrit, në raste gëzimi e hidhërimi. Vitet e punës në gjeologji me Martinin i forcuan këto lidhje, duke ndarë së bashku shumë vështirësi, që kishin punët e rënda e rrugët e largëta, shpesh herë nëpër bjeshkët e larta e me borë, në ditë me shi e ngrica, ku u rrezikohej jeta, por edhe dhja që u jepte bukuria përrallore e bjesh-

këve me namë.

13 vitet punë në Valbonë, Markaj, Liqeni i Ponarve, Kepenek, Qerem e Lugu i Vocit, krahas vështirësive, qenë një shkollë e vërtetë, ku ai mësoi shumë. Ato porosinë e përvoja e vyer e të atit, i shërbyen shumë për të ndërtuar marrëdhënie të shëndosha e miqësore me shumë shokë pune e kuadro të ditur, për të ruajtur vendin e punës që synohej e bëhej shumë konkurrencë (prej punëve të rënda në kooperativë bujqësore), për tu kualifikuar, për t’i besuar vende pune që i meritonte, për të iu dhënë mundësia e mbajtjes së lidhjeve me familjen e fshatin.

Aq sa i kërkohej për të ditur një ndër punëtorët më të përparuar, ishte shembull, se këtë e trashëgonte nga familja, studiointe e lexonte rregullisht, qëndronte pranë mjeshtrëve më të dalluar, përfitonte nga dijet e përvoja e personelit inxhinieroteknik, duke qëndruar në pararojë.

Për këto cilësi e të tjera, rritej ritmiksht në kategori, vlerësohej me stimuj moral e material, duke e aktivizuar edhe në pozicionin e zëvendës brigadierit e përgjegjësit të turnit.

Kudo e kurdoherë ka edhe konkurrencë pozitive e xhelozira, ka nepotizëm e lidhje familjare, çka pengojnë mbarëvajtjen e punëve e vlerësimet e merituar.

Ndonëse larg e pa ndonjë mbështetje, me propozimin e kolektivit, në vitin 1975, dekorohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Një ndër cilësitë e tij ka qenë e mbetet respektimi i traditave pozitive, thjeshtësia e respekti për njerëzit, dëshira për të lexuar e njohur me zhvillimet bashkëko-

hore. Ato ditë që isha në këtë fshat për një veprimtari me rastin e përrimit të përfundimit të rikonstruksionit të Kishës dhe jo vetëm (06.08.2022), u takuam shpesh e kujtuam shumë gjëra nga e kaluara.

I shndritën sytë e u harlis, kur takoi në Gurin e Misullave, disa bashkëfshatarë nga Gjakova të larguar në vitet e hershme të Pasçlirimit për arsye të regjimit. Nikë Pal Binakut e familjarëve të tij, u tregoi ku kishin pasur tokat e pemëtoret, livadhet e bjeshkën e u përkrahu pa asnjë xheloz (sepse ndodhë edhe e kundërta) dëshirën për të ndërtuar diçka në trojet e të parëve të Binak Avdisë. Edhe ajo shishe e vogël me raki, në atë rast takimi, i shoqëruar edhe nga djali i tij, ishte një gjetje e bukur e domethënëse që flet shumë.

Në takimet e shumta, kryefjalë e çdo bisede ishte shqetësimi e perspektiva e fshatit, e ndryshimeve, e arritjeve të mëtejshme për ta shndërruar në një qendër çlodhëse e kurative, e krijimit të mirave materiale e shpirtërore, larg shpërdorimeve e tjetërsimeve abuzive.

Përmenden e ka shumë emra e kontribuues në vlera morale e materiale: I ndjeri Martin Col Prebibaj (disa vite kryeplak i fshatit), Skënder Përpepaj, Mhill Geci, Dom Simon Kulli, Zef U. Mrishaj, Lekë Hysenaj, Dodë Mehmeti, Gjergj Prebibaj, Bafti Marku, Viktor M. Coli, Ndue e Lulash Vatnikaj, Agron Prebibaj, Dedë Qokaj, Lekë Vatnikaj, Agron Qokaj, Zef Gj. Mrishaj, Ndue Mitri e të tjerë. Investuan, qysh herët me 1991, për të bërë rikonstruksionin e parë të Kishës për mos degradimin e saj- vëllezërit Filip, Arben, Nikolin e Paulin Gjon Prebibaj.

lon punën fizike asokohe të quajtur “viti i stazhit”, në ndërmarrjen e ndërtimit “21 Dhjetori”.

Ndreka dhe Mimika në marrëveshje konspirative me pagetarin e ndërmarrjes i dorëzonin shumën e parave aq sa ishte paga e ndërmarrjes, pra ky defakto sipas tij, merrte sa dyfishi i pagës. Ky veprim i zgjuar s’ka nevojë për koment. Gjergji ndonëse i ri ishte ndër të parët, që u mor me biznes në fillim vitet 90’. Fillimisht, tregon ai, - shkuam në Mal të Zi me babën Ndreka dhe fillova biznesin, duke blerë dy magnetofona, më pas oreksi për tregti nuk pati të ndalur. Me kalimin e viteve biznesi i tij shtohet, forcohet dhe konsolidohet, duke arritur maja të larta.

Përveç pastërtisë së përfitimit ai veçohet për pagën e mirë të punësuarve. Kontributi i tij bamirës është i madh dhe i shumëllojshëm në fusha të ndryshme. Vlen të veçohet krahas shumë të tjerave ndërtimi I monumentit të Gjergj Kastriotit me përmasa gjigande, në Labinot Fushë. Për të ruajtur të gjallë trashëgiminë kulturore në fushën e teatrit dhe të kinematografisë. Gjergji pranë biznesit të tij ka ndërtuar një kinema për punëtorët, Kinostudio “Shqipëria Dje” vepër unikalë kjo në Shqipëri. Është shumë domethë-

nëse mbështetja, dhe gatishmëria për të investuar në vendlindjen e të parëve të tij, dhe mesazhet e publikuara në mbështetje të kërkesës legjitime të popullit të Dukagjinit për rikonstruksionin e rrugës ekzistuese, e cila kalon edhe në vendlindjen e Ndrekesë.

PËRCJELLJA E MIMIKËS

Ceremonia mortore ishte e veçantë, dhe e gjatë në kohë. Ishte një përcjellje siç e meritonte dhe e dëshironte artistja e madhe. Kishte një solemnitet të shkallës së epërme. Për ti dhënë lamtumirën e fundit Mimikës kishin ardhur miq dhe të afërm nga Gjirokastra deri në Dukagjin, por edhe nga vende të largëta, të cilët mbanin në dorë kurora dhe lule të freskëta. Në këtë ceremoni nderuan me pjesëmarrjen e tyre artistë të moshave të ndryshme, ministra, deputetë, drejtues të strukturave qendrore dhe lokale, jo vetëm nga Tirana, por edhe nga rrethe të ndryshme të vendit. Secili pjesëmarrës ravizonte cilësitë e njeriut të veçantë, duke theksuar se ajo jeton me veprën dhe kujtimet që la për të gjallët.

Një lamtumirë e këtij dimension i shkon për shtat vetëm një njeriut me shpirt të madh. Gjatë homazheve duhet vlerësuar një detaj mjaft i veçantë dhe

kuptimplotë. -Një grup burrash nga Dukagjini, teksa e nderonin, hoqën qeleshet e bardha dhe i vendosën pranë trupit të Mimikës. Mesazhet e ngushëllimit vinin nga personalitete të fushave të ndryshme.

Presidenti i Republikës Z. Bajram Begaj shkruan: “-U prehtë në paqe Mimika Luca! Trashëgimia artistike e Mimika Lucës është një pasuri që publiku shqiptar e ka çmuar dhe do të vazhdojë ta çmojë përgjithmonë!”

Kryeparlamentarja Znj. Lindita Nikolla: “-Sa trishtim! Mimika Luca, aktorja e madhe e skenës dhe ekranit shqiptar, u nda nga jeta! Mimika do të na mungojë të gjithëve, sepse imazhi paqësor dhe rolet e saj janë bërë pjesë e jetës së disa brezave! Ngushëllime familjes! Pushofsh në paqe, Mimika!”

Kryeministri Z. Edi Rama: “-Lamtumirë e dashur Mimika! Tanimë jeni përqaftuar me Ndreken dhe kjo do ta bëjë Gjergjin më të fortë, shpresoj!”

Ministrja e Kulturës Znj. Elva Margariti: “-Aktorja e dashur Mimika Luca u nda sot nga ne. Me një thjeshtësi natyrale e thellësi ka arritur të krijojë një galeri të pasur karakteresh. Brezat e rinj kanë shumë ç’të mësojnë nga trashëgimia që ajo ka lënë në kinematografinë shqiptare. U prehtë në paqe!”

Shoqata Atdhetare Dukagjini: “-Lamtumirë Mimika Luca-Nusja e Dukagjini. Shpirti yt pushoftë në Paqe!”

Shpirti i saj prehet i qetë, sepse lart në qiell bashkohet me Ndreken e madh duke krijuar një duet hyjnor, ndërsa në jetën tokësore len trashëgimtarin e boshtit të familjes, Ndreken e vogël. Mimika la pas një galeri të pasur me role me një thjeshtësi dhe vërtetësi natyrale. Ajo la emër të përvitshëm në jetën e saj tokësore.

Da Vinçi pat lënë një postulat të spikatur: “Ti që fle, më thuaj çka është gjumi? Gjumi i përngjan vdekjes. Atëherë pse ti nuk bën vepra në mënyrë që edhe kur të vdesësh ti përgjigjesh të gjallëve, ndërsa ti je i gjalle dhe i përgjigjesh te vdekurve të trishtuar”.

Tashmë Mimika nuk është në mesin tonë si njeri me staturë fizike, sepse u ngjiti lart në panteon, duke marrë rrugën për në parajsë. Yje si ajo ndriçojnë në përjetësi. Le të besojmë se largimi i saj nuk mund të jetë një arrati pa kthim.

Shqipëria humbi një aktore të madhe ndërsa Dukagjini humbi një nuse të dashur!

Mark BOBNAJ, Studiues

Pjesë e historisë, ndër kontribuuesit kryesorë, do të jenë Skënder Përpepaj, Mhill Nd. Prebibaj, Gaspër M. Prebibaj, Skënder N. Qokaj, Nikolin M. Vatnikaj, Besnik D. Vatnikaj, Fran V. Vukaj, Prelë Adem Përpepaj, Agron P. Përpepaj, Dedë Z. Ndrevataj, Gegë M. Prebibaj e të tjerë emra (e pamundur të përfshihen në një shkrim si ky).

Para 53 vitesh-në shtëpinë e Dedë Zef Prebibajt

...Jeta është shumë interesante, me shumë larushi, ngjarje të pritura e të papritura, me befasi e koincidenca të çuditshme.

Në vitin 1969, me mësuesin Pjetër Hasaj, me një moshë më të madhe se unë, me të cilin vit pas viti shtuam e forcuam shoqërinë e miqësinë, u nisëm për në Curraj Epër. Me se më kujtohet organizohej një mbledhje e Bashkimeve Profesionale të asaj kohe, apo një punë kualifikuese e mësuesve. Atëherë nuk kishte bujtina as hotele, por në çdo shtëpi gjeje një mikpritje e bujari të radhë.

Ndonëse patëm edhe mundësi të tjera e lidhje familjare, Pjetri më propozoi të shkonim në shtëpinë e Dedë Zef Prebibajt, e atij burri të njohur për shumë cilësi pozitive të vyera e në veçanti për një mençuri të hollë. Ajo natë e gjatë e vjeshtës së vonë e fillim dimri, qe shumë e paharruar e magjike.

Jo vetëm kisha dëgjuar shumë, por edhe e njihja pjesërisht Dedë Zefin, gjithnjë me një farë distance për arsye largësie, moshe e ku unë e ku ai, i shquar në kuvende e soba burrash.

Ndonëse, jo i paditur e i panjohur me traditat e me vlerat e shumta të malësorëve, (kryesisht të fjetura e të pa zbuluara sa duhet), u befasova e mbeta si i shtangur nga ato që pashë e dëgjova në atë natë të gjatë, që më ngjau shumë e shkurtër.

Mësuesi e udhërrëfyysi im ishte një specialist në këtë fushë e dinte të orientohej me mjeshtri e "të gërmonte" me kujdes atje ku "flinin e fshiheshin" vlerat, siç kërkojnë perla e mineral të çmuar pasionantët e pa dekurajuar.

Tani e kuptoj mirë, se, të dy mysafirët e respektuar, e kishim një mangësi serioze të kohës, se nuk evidentonim me shkrim ato rrëfime të arta që mishëronin mençurinë popullore.

E shikoja të zotin e shtëpisë, duke e vërejtur me shumë kujdes: i thjeshtë e komunikues, i ngrohtë e dashamirës, serioz e bindës në ato që thoshte, ashtu rrjedhshëm e pa mendjemadhësi.

Me sa kisha lexuar e mësuar në shkollë të mesme e atë vit pune si mësues, mundohesha të veçoja ato tiparet më domethënëse fizike e shpirtërore tek ky njeri mes malesh kreshnike.

Nuk dua të himnizoj, por mu kujtuan vargjet e Naim Frashërit tek "Historia e Skënderbeut" për Kamanin, atë personazh të krijuar nga autori i mirënjohur, sigurisht se i mbështetur e frymëzuar nga një realitet konkret, me shumë ngjashmëri tiparesh me portretin e Dedës.

Ish Kamani, q'ish burrë/ Nuk i trembej syri kurrë/ Pa e donin shqipëtarët/ I holl' isht' e pak i gjatë/ Nukë kish shumë mustaqe/ Vij si i zeshkët e i thatë/ E s'kish fare mish mi faqe/ Kishte gjithë urtësinë/ Me një zë të ëmbël fliste/Fjal' e tij e bint njerinë/.

Me dhjetëra të tillë mund të numëroje

në Curraj Epër. Për çdo krijues të çdo fushe, do të ishte fatbardhësi e burim frymëzimi, për të zbuluar e krijuar personazhe e heronj të pashoq, të konkurrueshëm me ata me përmasa kombëtare dhe jo vetëm.

Herë-herë më dukej enigmatik, që bluate imtë e përpunonte në mendje me bashkëmoshatarët e tij, atë materie që i

rrahje gjoksi. Nuk po e them unë, por janë me qindra e më shumë ata që e kanë pohuar e kanë përfutur nga filozofia e tij popullore.

Mendja e njeriut e ka kërshërinë e aftësinë të veçojë, të seleksionojë e të gjykojë për gjërat më dalluese, që bien më shumë në sy...pse jo t'u mësojë edhe historinë.

Deda- milic 3 vite në Qafën e Malit në

i Partisë e Shtetit të asaj kohe, foli edhe Deda, i veshur me kostum kombëtar e, mes të tjerash, kërkoi rrugë makine për në Curraj Epër.

Për ta konkretizuar sa thashë më sipër, më vjen në ndihmë edhe një shkrim i botuar në gazetën "Zëri i Rinisë" (vitet '80) nga publicisti e krijuesi i mirënjohur Zeqir Lushaj me titull "Dyqani i



Kulla e hershme e Dedë Zef Prebibaj

dha emër Currajve, jo vetëm për trimëri, por edhe për mençuri, për ndjesi të holla të pashoqe në krijimin e folklorit në përgjithësi dhe eposit në veçanti. Kisha dëshirë ta vëreja e vështroja me kërshëri atë shtat e konstrukt për t'u pasur lakmi (jo zili), me atë mendje brilante, me një të folur të sistemuar, jo rrëmujshtëm e me

kohën e Zogut, më vonë mori pjesë në Luftën Nacional-Çlirimtare-partizan 6 muaj në Elbasan në Brigadën e 23-të, një burrë i nderuar e respektuar në vendlindje e më gjerë, që i dëgjohej fjala e matur dhe e guximshme, pse jo edhe kritik ndaj padrejtësive. Në qershor të vitit 1983, kur në Nikaj-Mërtur erdhi për një vizitë Nr.2

mendjes", i cili citon Dedën: "Mbledhjet e popullit, odat e burrave, bisedat familjare e shoqërore, gazetat, lajmet në televizion, dasmat e vdekjet...ja, këto janë, more djalë, dyqani i mendjes".

Kur ushtritë serbo-malaziasë dogjën Malësinë e Gjakovës, Deda strehoi familjarisht për disa kohë babain e Zeqirit, Sadik Selmanin e Grisë, me të cilin u bënë

miq për kokë, krah tyre edhe Halil Dauti i Bëtoshtës.

Tre familje bujare në kohë të vështira, nje lidhëse mes 3 fshatrave e më gjerë, tre burra të mençur e mendje-hollë, në trekëndëshin e pacenueshëm Curraj- Qafë Kolçi-Blini i Grisë, që do të kujtohen gjatë.

Kaluan vite e unë, pas mbarimit të shkollës së lartë, u emërova mësues po në këtë fshat. Përjetova e zbulova shumë vlera në këtë oazë mrekullish, me bukuri marramendëse e pasuri të pashoqe shpirtërore...

"Suka apo Logu i Kishës", ka qenë arena



Kulla e re e Dedë Zef Prebibaj

e Amfiteatrit natyror Curraj, ku këta filozofë e oratorë popullorë “mprehën shpatat e mendimit”, “u shkolluan” e bënë “duelë” për t’i pasur lakmi edhe greko-latinët e hershëm. Çdo pas dite të vonë, pothuajse rregullisht, popullohej me spektatorë të shumtë ajo qendër e kjo ka qenë sprovë e madhe, që ka sjellë përsosjen e fjalës e mendimit, privilegj që ia ka falur natyra vetëm këtij fshati. Duke ruajtur etikën, “flakëronin shpatat dinjitoze e duelet lakonike”, por edhe limimet, deri në përsosje, të asaj gjuhe të drejtpërdrejtë e metaforike, me humor, ironi, simbole, alegori, etj. Të rrëmbente e ndjeje kënaqësi, kur shpërfaqej tradita pozitive e maturia.

Kam qenë dëshmitarë i sa e sa rasteve të tilla kur dëgjoja: Dedë Zefin, Gjesh K. Lekën, Mark Grimicin, Zef Mirashin, Mitër Kolën, Zef Isufin, Vatë Mirashin, Hasan Lulashin, Kolë Buçën, Zef A. Sylën, Mark Baftinë, Sokol Markun, Xhemë Sadrinë, Nikë P. Musën e shumë të tjerë, që ishin nxënësit e Profesorëve e mësuesit e brezit të ri, për të ruajtur me sakrificat atë gjuhë hyjnore. Edhe aty kishte teza e antiteza, kishte “pozitë e opozitë”, çka autorët e aktorët nuk e dinin teorikisht, por e zbatonin në praktikë, duke përfunduar në gjetje pozitive.

Dihet mirë, se ky fshat, larg qendrave urbane, është një ndër vatrat më të shquara, ku jeton pothuaj në çdo shtëpi perla e “Ciklit të Kreshnikëve”.

Në “Epikën Historike”-1 (Akademia e Shkencave e RPSSH, 1988) janë të shënuara “Gjergj Elez Alia” Nikaj-Tropojë, 1924; “Lufta e Kreshnikëve me Krajl Kapedanin”, Nikaj, 1924; “Kreshnikët e Llabutani” Curraj Epër, 1924.

Në “Epikën Legjendare” (Vëllimi 1, Tiranë 1966), nga krijimet e mbledhura në 46 krahina të Shqipërisë, 16 prej tyre shënohen në Curraj Epër (shumica me 1931), që përbëjnë afërsisht 1/3 e sasisë.

Në skajin tjetër më të largët të krahinës, në fshatin Bricë, Sokol Martini dinte mijëra vargje përmendësh.

Pa dyshim se Nikaj-Mërturi e krahinat përreth, janë krijuesit e bartësit e këtyre vlerave monumentale. Një gjë të tillë e kanë pohuar studiuesit Palaj e Kurti, rusja Agnia Desnickaja, Ernest Koliqi, Zihni Sako e Qemal Haxhihasani, nga Instituti Shqiptarë i Folklorit, Instituti Albanologjik Prishtinë e të tjerë personalitete vendës e të huaj (më hollësi mund të gjeni në librin “Krenari për vendlindjen”-triptik për Nikaj-Mërturin- Frrok Vukaj, fq.78-90, Tiranë 2006).

Janë të gdhendur në historinë e Folklorit emrat e Mirash Gjonit, Dedë e Shan Zefit, Mhill Prekës, Kolë Brahimit, Lulash Zefit e të tjerë. Edhe në botimi françeskan, që përmenda më sipër, dy vëllezërit (Deda e Shani), kanë të shënuar dy krijime për Majin e Hallin. Në këto përmbledhje bie në sy edhe emri i Marash Sokolit nga Thëthi, daja gjyshi i Mill Nda. Prebibajt. Pa e ditur, bartësit e këtyre vlerave, kanë dhënë një kontribut të shquar në pasurimin e folkloristikës, stilistikës gjuhësore e oratorinë, i cili meriton studim e vlerësim.

Mhill Ndue Prebibaj dhe brezi i tij

Këto vitet e fundit, trashëguar edhe nga e kaluara, kam vërejtur një dukuri pozitive tek një pjesë e konsiderueshme e brezit të ri: thjeshtësinë e jo vetëmburrjen, punën



këmbëngulëse e jo dembelizmin, rrishtimin e sakrificat serioze për të përparuar e kompensuar kohën e humbur.

Bashkë me Ndue Dedë Zefin, gjatë asaj vizite, pashë edhe shumë djem simpatikë, modest e të dashuruar me vendlindjen e mallin për njerëzit, pa harruar ata më të moshuarit, madje edhe 3 breza, që vinë herë pas here në vendin e origjinës: Nga Amerika-Prelë Adem Përpepaj e Gjesh Qun Ndrebataj (ky i fundit afër 100 vjeç, i biri Martini, gruaja e 3 fëmijët-tashmë të rritur); Nikë Pal Binaku familjarisht, të ardhur nga Gjakova e Prishtina, ndër-sa Marashi e Mushaku nga Zvicra etj. (Marashi thirrej Kastriot, por i ati, për modesti, ia ndërroi emrin...). Pak nga pak, nëpërmes bisedave e takimeve, u njohëm e rinjohëm, u shoqëruam e miqësuaam me njëri tjetrin.

E thashë “u rinjohëm” se shumë prej tyre, kur unë kisha qenë mësues në këtë fshat në vitet 1974-75 e pak ditë në fillim vitit 1976, ata më kujtonin, madje edhe disa, që nuk u kisha bërë mësim. E ndjeva veten shumë mirë, kur takova ish miq e shokë, ish nxënës e kolegë, ish moshatarët e mi e fëmijët e shokëve bilës edhe të ish nxënësve. Jo vetëm që nuk kishin të sharë, po edhe unë, ndjehesha krenarë për ata djem, që kanë lënë emër të mirë brenda e jashtë vendit.

Mhill është njëri mes dhjetëra e dhjetëtarëve të rinjve nga Curraj, me mallin e dashurinë e pashuar për vendlindjen, për krahinën e për njerëzit, me dëshirën e madhe për të kontribuar e bërë ndryshime pozitive. Me të atin, siç e thashë edhe më lart, njihem prej shumë vitesh e kënaqemi, kur bisedojmë lirshëm e herëherë edhe me pasion, ndërsa Mhilli, më serioz e më i matur në mendime, duke trashëguar edhe traditën e t’ parëve ku lindi e u rrit, pa mohuar se, nipat marrin shumë edhe nga dajallarët. Patjetër duhet shtuar edhe shkolla e jetës, vitet e gjata në migrim e emigrim, që e kalitën e burrëruan, që diti me përvetësua e mishërua edhe frymën civilizuese perëndimore. Jo e lehtë dhe e shtruar me lule ka qenë as rruga e Mhillit. Flet pak, por flasin shokët e disa gjëra më thotë edhe i ati, ashtu shoqërisht, pa e ditur se mund të shkruaj diçka. Në një moshën relativisht të re, arriti me njohë edhe atë zhgënjim të para viteve ’90, kur ishte nxënës në një shkollë të Mesme në Fieri, më vonë po ushtar në këtë qytet e në B. Curri, disa vite punë kuzhinier e punëtor në Ndërmarrjen Gjeologjike, ndonëse ia quanin privilegj, krahasuar me

të thellë.

Është një ndër kontributorët kryesorë për t’ia ndryshuar faqen Currajve. Fillesat kanë qenë e janë shumë premtuese, konkrete e jo me rrahje gjoksi, pa e ditur mirë se kë të përmendësh më parë. Ashtu si pa dashje mu kujtuan vargjet: - “Çka ka thanë ky krajl Nikolla/ N’Curraj Epër nuk mund dola/ Për çdo shpi kish pas Sokola”.

Rruga e Makinës, Rikonstruksioni i Kishës, Kryqi në Rrasën e Currajve, ura e rrugë, shumë shtëpi të rikonstruktura e ndërtaura, varreza të rregulluara, janë disa nga investimet e bëra, pa pasur mundësinë të evidentoj shumë kontribute të tjera për familjet e tyre e rrethin familjarë. Shtëpia vilë, e bukur e funksionale, jo larg nga qendra e Shkodrës, me një bahçe të mirëmbajtur me kujdes nga i ati, mishëron edhe mundin e djersën e Mhillit, pa mohuar kursimet e punën fizike të të atit. (Aty për karshi edhe një hapësirë e konsiderueshme e një ngrehinë, e blerë dhe privatizuar nga kjo familje). Punësimi i një punëtoreje për t’u kujdesur për prindërit, për mjediset e brendshme e të jashtme të godinës, është një vlerë tjetër dashurie e respekti.

Për të qenë i sigurtë, kur u takuam më së pari, unë nuk e njihja, por ai pohoi se më mbante mend qysh se fëmijë e më vonë, kur vija në Curraj tek djali i hallësime. Unë, po jam disi në dilemë “nga frika” e ndonjë kritizeri, për të shënuar edhe sa më tha në një rast bisede: - “Po ma dërgove një njeri në emrin tënd, do ta rregulloj unë; je i mirëpritur edhe për një vizitë në çdo kohë që të dëshirosh”; kjo e dyta, është disi tunduese, po qe se shëndeti më ecën mirë. Këto oferta unë i kuptoj edhe si vlerësim për më të moshuarit, për mësuesit e për shokun e babës. Unë u gëzova jashtë mase, kur mësova se 4 fëmijët i ka të arsimuar, që flasin shqip, ruajnë lidhjet e traditat prej nga kanë origjinën.

Ka tipa që vënë gjyzykë të errëta e gjithçka u duket zi; kërkojnë e gjurmojnë me sqimë si maniakë për të zbuluar mangësi e negativitet, madje edhe tek moshat e reja; të kërkojnë qimen në vezë e ta bëjnë tra. Kush mbi tokë nuk ka pasur e ka ndonjë mangësi?! Jo gjithçka është e përsosur dhe e përkryer në natyrë e aq më pak në shoqëri, por ka aq gjëra të bukura e me shumicë, sa të mrekullon puna e palodhur, shpirti human e sjellja e bukur. Në shoqëri, sigurisht se ka shumë vlera të pa evidentuara e të pa promovuara, por besoj, se studiuesit, krijuesit, publicistët, sociologët e historianët, do ta plotësojnë këtë kuadër pak e nga pak, me realizëm e objektivitet, vërtetësi e pa falsifikime. Curraj i bekuar nga Zoti, por i braktisur nga shteti.

Në këto veprimtari pati shumë pjesëmarrës, migrantë e emigrantë, më shumë ish pushtetarë se pushtetarë, indiferencë reale nga organizmat shtetërorë, shumë dashuri, pse jo edhe zhgënjime. Jam besimplotë, se do të gjenerohen energji të reja, duke arritur në një emërues të përbashkët...

Shpresoj, se nuk do të jetë e largët dita, kur një rrugë tjetër, më funksionale, më e shkurtër e më e bukur, do ta lidhë fshatin me qendrën e zonës.

(Tetor 2022)

punën sflitëse në kooperativë bujqësore.


Pas viteve ’90, iku, si i thonë, nga shiu e ra në breshër, duke përballuar me vendosmëri shumë pengesa serioze në emigracion; pak vite në Itali e shumë të tjera në Mbretërinë e Bashkuar.

Kësaj rinie, i kam bërë edhe unë vlerësime e kritika, por, me krenari duhet pohuar, se ka bërë e bën mrekullira, është një gjenerator që ka shtyrë përpara shoqërinë e ruajtur identitetin kombëtarë, i krijuar me aq sakrificat nga baballarët tanë; ka lënë vepra të shquara, tregues të mbijetesës e pathyeshmërisë, të trashëgmisë sonë të vyer. A nuk janë dëshmi e heroizmit rinorë udhët e hekurta, fabrikat e uzinat, hidrocentralet e brezaret e pafund, bonifikimet e mijëra kilometra rrugë të ndërtaura në kushte të vështira e me shumë sakrificat; a nuk janë pothuajse në çdo shtëpi e çdo fshat rikonstruksionet e ndërtime të bukura bashkohore e të traditës, ndërtime të tjera në qytete me emër të Shqipërisë (madje edhe jashtë vendit) e në rrethinat me tokë pjellore, edukimi atdhetarë i fëmijëve, bizneset etj...

Me sa kam kuptuar, Mhilli, është një ndër ata curraj e shqiptarë, që ka mbijetuar me sukses në Londër. Kur bisedojmë në dreka e darka, në kafene e në sofrat malësore, kur themi se “xy” ka arritur suksese e ka mbijetuar, është një fjalë goje, që e themi me dashamirësi a me xhelozji, por harrojmë, se sa mund e djersë, sa vullnet e përpjekje, sa dështime e rrëzime, sa trauma e orë pa gjumë, sa punë e orë pa gjumë, është dashur për të arritur deri në sukses. Me sa më thanë, ai ka një kompani ndërtimi me afro 20 veta, me të cilët punon çdo ditë; ka ndërtaur e ndërton marrëdhënie pune korrekte e humane. Kup-tohet, se kjo arritje jo e vogël as e lehtë, ka një histori mbijetese e konkurrence të egër vlerash e jo vlerash, në atë perandori të Mbretërisë së Bashkuar, një ndër vendet më të fuqishme të botës.

Jo pa dashje përmenda edhe frymën humane, e cila është një ndër vlerat më pozitive të njeriut. Në shumë raste ato 3-4 ditë, kur më rastisi të takohem në mjediset familjare dhe jo vetëm, pashë, ashtu si fshehur e pa u ndjerë, tek nxirrte nga xhepi kartëmonedha me vlerë të konsiderueshme për të bërë çoka a për të ndihmuar e respektuar bashkë krahinasit e vet. Tronditja shpirtërore, përkushtimi e të gjendurit pranë me përkujdesje maksimale, kur një kushëriri i ndodhi një aksident me rrezikshmëri të madhe (tetor 2022) janë një tregues tjetër i humanizmit

Pse njeriu krijon skenarë të rrezikshëm në kokë?



LEKË IMERAJ
shkrimtar, përkthyes, publicist

Skenarët e rrezikshëm në kokën e njeriut, janë produkt i ideve fikse, ide të fiksuar në trurin e tij. Në raste të tilla kemi të bëjmë me njeriun e sëmurë, i cili, vuan nga çrregullime të forta psikike. Shumë të sëmurë të këtij lloji, nga turpi dhe rrezikshmëria e skanerëve të tyre, i fshehin shqetësimet e tyre, edhe brenda familjes.

Skënderi, kishte 15 vjet, që jetonte me gruan. Nga martesat linden tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë. Gjithçka shkonte për mrekulli. E donte shumë gruan dhe familjen e vet.

Pa asnjë shkak të jashtëm, atij, i lindi ideja që t'a vraste gruan. Kjo ide, gjithnjë e më shumë, përforcohej në kokën e tij.

Jo, ai kurrësesi nuk donte t'a bënte një krim të tillë. Dhe, pse? Pa asnjë shkak. Nga frika se do t'a vraste natën në gjumë, u nda nga krevati bashkëshortor dhe, u rregullua në një dhomë tjetër, për të fjetur. Para se të shtrihet në krevat, e mbyllte derën me çelës dhe, në errësirë, e vërviste çelësin, pa e ditur se ku binte. Dy vjet zgjati dilema e tmerrshme, midis vdekjes dhe jetës së gruas së tij. Por, pavarësisht nga përpjekjet për të mos e vvarë, nuk ia doli. Ai nuk arriti të çlirohej nga pushteti

i idesë fikse. Nga momenti i kryerjes së krimin, nuk e dinte se kush ishte. "U mundova shumë por, nuk arrita të çlirohesh nga ideja e vrasjes. Ajo ishte e plotpush-tetshme mbi mua. Unë, nuk e vura dot nënkontrollin tim", - sqaron ai.

Skënderi, kurrë në jetën e vet, nuk kishte dhunuar njeri, madje, asgjë të gjallë. "Nëse më futet një grerëz në shtëpi, nuk e vras. Hapi derën, dritaret dhe, e nxjerri jashtë", - tregon ai.

"Kur më lindi kjo ide, dyshova tek vetja e ime: Jam çmendur?", - thotë ai.

Skënderi, nuk është rasti i vetëm. Janë një numër i madh njerëzish, shumë më tepër nga sa mendohet, që vuajnë nga kjo sëmundje. Psikologët mendojnë se, rreth dy përqind e popullsisë, në çdo komb, burra dhe gra, vuajnë nga idetë fikse. Numri i grave që vuajnë nga idetë fikse, është, thuhet, i njëjtë me atë të burrave por, kryejnë shumë më pak krime.

Dr. Bernhard Osen thotë: "Në të shumtën e rasteve, tek i sëmuri, mendimet e detyruara, shkaktojnë disa rituale sjellje, të caktuara nga vetë ai. I sëmuri nuk guxon të ecë në fugaturën midis pllakave në rrugë. Vazhdimisht i duhet të kontrollojë nëse e ka mbyllur derën e shtëpisë, të makinës, rubinetin e ujit apo çelësin e dritave... I sëmuri e din se, ritualet e tij dhe veprimet që ai kryen, janë të pakuptimta dhe, absurde megjithatë, nuk heq dot dorë nga ato".

Si dhe, pse krijohen idetë fikse në trurin e njeriut?

Psikologu Thomas Hillebrand thotë: "Të sëmurët me ide fikse, në përgjithësi, kanë kërkesa të mëdha morale ndaj vetes së tyre. Janë tipa të cilët, në çdo kohë dhe rast, duan të jenë perfekt, prandaj vuajnë nga presioni i brendshëm. Shumë prej tyre nuk ndjehen të sigurtë në mjedisin ku jetojnë. Ndjehen të kërcënuar dhe vuajnë nga ndjenja e frikës. "Ferri" që, ata përjetojnë në kokë, nuk ka të bëjë me karakterin e tyre. Në 85 përqind të rasteve, simp-

tomat e sëmundjes shfaqen para moshës 35 vjeç. Shumë prej tyre, kanë përjetuar sjellje të detyruara që, në fëmijërinë e hershme. Stresi në familje, dhuna fizike dhe psikike, braktisja nga prindit në moshën e adoleshencës, izolimi nga frika, kontrolli i tepruar, heqja e iniciativës për veprim të pavarur, janë burime të kultivimit të sjelljes së detyruar tek fëmijët.

Trashëgimia gjenetike, pavarësisht nga shkalla e influencës, mbetet një burim i njohur dhe, i pranueshëm në rastin e sëmundjes."

Tek të sëmurët si Skënderi, detyrimi shfaqet në formë impulsive, gjë kjo që shkakton veprime të pakontrolluara.

I sëmuri, automatikisht, jashtë vullnetit të vet, mendon se po e ndjek dikush. Kthehet nga rruga në shtëpi, duke menduar se ka lënë sobën të ndezur apo, rubinetin e ujit të hapur. Nëse shikon dy apo më shumë njerëz bashkë, kolegë pune apo të njohur, mendon se diçka po komplotojnë kundër tij. Kjo ndodh edhe për njerëzit në familje dhe të afërmit. Gruaja mendon se, burri, me fëmijët dhe, të afërmit e tij, po komploton diçka kundër saj. E njëjta gjë mund të ndodh edhe me burrin. Dr. Osen thotë se, 73 përqind e rasteve të xhelozisë, janë pasojë e ideve fikse, pa asnjë provë dhe fakt.

"Këto sjellje të detyruara, nuk janë vullneti i të sëmurit. Fjala është për një sëmundje diktuese, kur dikush, një apo më shumë orë në ditë, ndodhet psikikisht i detyruar të kryej veprime të pavullnetshme të cilat, ia vështirësojnë dhe rrezikojnë jetën e vet dhe, të të tjerëve", thotë psikologu Osen.

Skënderi është i sëmurë. Në "ferrin" e ndërtnuar në kokën e tij, zhvillohet filmi horror, për vrasjen e gruas së vet.

Jo vetëm kaq.

Një ditë, të dy djemtë e tij, shkuan në plazh me dajën e tyre të rritur. Skënderin, pas pak orësh nga largimi i tyre, e

mbërtheu paniku: Djali i vogël, të cilin e kishte dëbolesë të madhe, mund të mbytet, mendoi ai.

"Djali i im do të mbytet, do të vdesë, unë nuk do t'a shikoj më", - mendoi ai. U ngrit me vrap dhe u turr drejt plazhit. Kur e mori djalin në prehër, mendoi t'ia zhyste kokën në ujë dhe, të numëronte deri në tridhjetë, sa të vdiste.

Skënderi, shpesh kishte menduar që, t'i fuste të gjithë njerëzit e familjes në makinë dhe, të përplasej pas një peme apo shtylle, në anë të rrugës.

Dr. Osen thotë: "Problemi nuk është vetëm mendimi kriminal në kokën e të sëmurit por, frika për t'a realizuar atë. I sëmuri nuk dëshiron t'a realizojë skenarin e krimin që ka në kokë".

A mund të mjekohet dhe shërohet i sëmuri me ide fikse?

Dr. Osen shprehet shumë optimist, për mundësinë e mjekimit të kësaj sëmundje.

Ai thotë se, mundësitë e mjekimit janë dy: Psikoterapia dhe medicina. Suksesin e mjekimit ai e lidh me kohën e fillimit të mjekimit. Sa më shpejt që pacienti paraqitet tek mjeku, aq më i mundshëm është mjekimi.

Osen thotë, një numër shumë i madh i të sëmurëve, pas gjashtë apo më shumë vitesh nga shfaqja e simptomave, paraqiten tek mjeku. Kjo është shumë vonë. Të sëmurët kanë frikë dhe, turp të shkojnë tek mjeku për arsye se, të tjerët do t'i mendojnë të çmendur.

Të jesh i sëmurë, nuk është turp. Turp, madje, edhe krim është, të fshehësh me qëllim sëmundjen.

Një shërim i plotë, ashtu si dhe në rastet e tjera të sëmundjeve psikike, mund të arrihet rrallë. Megjithatë, veprimet e detyruara ditore, shmangen shumë.

Osen thotë: "Rreth 60 përqind e të sëmurëve, përfitojnë përmirësim të mirë dhe, shumë të mirë. Shumë prej tyre, për vite të tëra janë pa simptoma".

Idetë fikse, në situata psikikisht të rënduara, riaktivizohen.

Të tilla mund të mendohen, humbja e vendit të punës, krizat në familje, prishja e martesës, vdekja e të afërmeve, sëmundjet e rënda e të tjera.

Në vdekjen e një mikeshe!

Pak ambientim për një nga poezitë më të mistershme

Më 5 janar 1987, Lidia Macchi, një studente universitare 21 vjeçare, gjendet e vvarë me 29 goditje me thikë në pyllin Cittiglio (Varese)-Itali.

Një i njohur dhe mik i Lidia-s, me emrin Stefano Binda, në atë kohë 19-vjeçar, arrestohet më 15 janar 2016 dhe dënohet nga Gjykata penale e Varese-s (e krimeve të rënda) me burgim të përjetshëm në shkallë të parë në prill të vitit 2018 dhe pastaj vlerësohet i pafajshëm nga Gjykata e Apelit të Milanos, më 24 korrik 2019.

Duke mos pasur prova të sigurta si në kohët e sotme, dyshohet që autori i vrasjes të jetë ai që ka shkruar një poezi dhe ia ka postuar familjes Macchi në mënyrë anonime, më 10 janar 1987. Megjithatë, analiza e tekstit të poezisë nga ana e krim-



inologëve ekspertë e përjashton hipotezën që autor i kësaj poezie të ketë qenë vrasësi i Lidia-s, por ka gjasë që ky tekst të jetë përpiluar nga një anëtar apo i afërm i Lëvizjes Katolike Comunione e Liberazione, ku bënte pjesë edhe viktima, vdekja e së cilës krahasohet me atë të Krishtit të

pafajshëm. Zarfi, në të cilin gjendej poezia me titull "Në vdekjen e një mikeshe" ka vulën e zyrës postare të Varese Centro të datës 9 janar 1987, në orën 16.00, më shumë se 48 orë nga gjetja e kufomës së trupit të Lidia Macchi.

Ja poezia anonime, që mbërriti tek familja Macchi, dhe që përshkruan se si Lidia pësoi vdekjen që të mbronte virgjërinë e saj, që si çdo subjekt i besimit të krishterë, e konsideron atë si një vlerë të paprekshme:

NË VDEKJEN E NJË MIKESHE

Vdekja bërtet
kundër fatit të saj.
Thërret me tmerr
pse është vdekje:
Cezurë e llahtarshme,
sflitje mishrash.
Vdekja bërtet
e bërtet
Njeriu i Kryqit.
Refuzim,

refuzimi i madh.

Lufta

lufta e përhershme.

Dhe Nëna,

Nëna e butë

me vëllazërit në vaj.

Përse unë?

Përse ti?

Përse, në këtë natë të akullt,

ku yjet janë kaq të bukura,

trupit është i fyer,

Perdja e Tempullit të ndarë,

prehet.

Si mund të qëndrosh

i varur mbi dru.

Në emër të drejtësisë,

në emër të njeriut

në emër të respektit për njeriun

largoje prej nesh këtë kelk!

Por zonja e errët

shpall me zë të lartë

arsyet e saj.

Cunsummatum est (U krye!)

(vijon në faqen 13)

Krenohemi me Prof. Mr. Blerim Gashi nga Prizreni

- Profesor Mr. Blerim Gashi mik i artistit Ikli Punavia nga Mati -

Të flasësh për prof. mr. Blerim Gashi duhen shumë fjalë e kohë, sepse është i palodhur në shërbim të artit, kulturës, sportit, çiklizmit, koreografisë dhe aktrimit.

Duke shikuar këto kontribute të veçanta që prof. mr. Blerim Gashi jep në shumë shoqëri kulturore - artistike në mbarë trojet shqiptare, si një artist i veçantë dhe duke kontribuar në fusha të ndryshme siç e theksuam më lartë, por kohët e fundit "PROMEDIA", në bashkëpunim me prof. mr. Blerim Gashi dhe kolegët e tij, në Prizren ishin ideator dhe inspiratorët e parë për zhvillimin e disa "Dramave", të titulluara: "DY JETIMAT", "TRADHËTIA", "FALJA E GJAKUT" dhe të tjera do të shfaqen në vijimësi, ku këto drama tregojnë originalitetin që kanë ndodhur dhe ndodhin sot në bashkësinë shqiptare e më gjerë, duke qenë shembull për brezat në vijimësi, si tregues i denjë dhe parajlmëruar për të ndaluar këto ngjarje që janë pjesë e dhimbjes në jetesën e sotëm.

Dramat të realizuar aq bukur dhe domethënëse duam të theksojmë aktruesit e talentuar që kanë luajtur aq bukur me një seriozitet që duhej të shfaqej në këto drama për t'ju a bërë të njohur brezave të ardhshëm.

Grupi realizues: Regjia: Prof. mr. Blerim Gashi e Elbasan Kryeziu; Kamera: Jashar Bytyqi e Drilon Zekaj; Montazhi: Jashar



Prof. Mr. Blerim Gashi, në momentin e marrjes së titullit "Mlrenjohja" nga komuna e Prizrenit

Bytyqi; Muzika: Vedat Lushtaku; luajtën rolet: Abaz Qengaj, Vushe Mjaki, Beqir Beqaj, Artesa Retkoceri, Sali Kryeziu, Edona Morina, Tringa Balaj, prof. mr. Blerim Gashi, Bedi Kiçina dhe Ilir Sulej-

mani dhe Producent: Nait Bytyqi.

Këto jo vetëm që kanë luajtur aq bukur, por kanë treguar se vërtet këto role janë ngjarje të njohura që kanë ndodhur në kohën e sotëm.

Prof. Mr. Blerim Gashi ka kontribute të veçanta në çdo fushë dhe rrallë i gjen njerëzit si ky, duke shpalosur vlerat mbarëkombëtare dhe duke qenë një shembull për brezat e ardhshëm, sepse kontributi i tij si mësues, drejtues, aktrues, sportist, artist, koreografi i njohur në Prizren, duke kontribuar në shumë shoqëri, ansamble të ndryshme kulturore në mbarë trojet shqiptare, duke pasur një rol të rëndësishëm në Ansamblin Folklorik Burimor Mbarëkombëtar, mik i shumë personaliteteve të njohur në fushën e artit dhe kulturës shqiptare, duam të theksojmë se ky njeri i palodhur dhe i nderuar është mik i veçantë në Grupin Folklorik "Besa Shosh" Dukagjini, me drejtues zotin Ndoc Fusha, artistët Gjon Kosteri, Gjellosh Kol Fushaj, Prele Milani, Kol Martin Aramadhi, mik i Grupit Folklorik "Petalba" bashkia Klos i ish- kryetarit të atij grupi, zoti Ikli Punavija, artistët Ferit Hoxha, Avni Hoxha, Veri Koburja, Ibrahim Kthella, këto miq të veçantë janë nga Kosova ndaj Grupit Folklorik "Petalba" Bashkia Klos si Prof. mr. Blerim Gashi, Poeti i njohur në Prizren, zoti Dashnor Gërmizaj, poeti Murat Gashi, Xhevdet Krasniqi e të tjera.

Blerim Gashi në kontributin e tij të veçantë në çdo fushë duam t'a theksojmë një kontribut të jashtëzakonshëm ka edhe në themelimin e Ansambilit Folklorik Burimor Mbarëkombëtar që është themeluar me datën 20 janar 2020, me degë në Prizren, ku zoti Gashi ka rolin e kryetarit të Kuvendit Mbarëkombëtar të këtij ansambli folklorik, që sapo është krijuar nga një grup insiatorësh si Jakup Krasniqi, Dashnor Gërmizaj, Blerim Gashi, Ikli Punavija, Hajri Ismani, Burhan Limani, Ndoc Fusha, Gjon Kosteri, Gjellosh Kol Fusha, Ferit Hoxha, Avni Hoxha, e të tjerë, artistët popullorë nga mbarë trojet shqiptare, nga Republika e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Diasporës dhe Republika e Kosovës.

Është për t'u admiruar dhe përgëzuar kontributi dhe puna e tij e palodhur e prof. Mr. Blerim Gashi, sepse vullneti, dëshira, pasionin që ka për çdo fushë, është si

një pasaportë që vlerat e tij mbeten në kujtesën tonë brez pas brezi.

Me dramën e realizuar aq bukur me kolegët e tij janë shumë domethënëse si "Dy JETIMAT", rol që vërtet të mbetesh jetim je si shqiponja pa krah, "TRADHËTIA", në kohën e sotëm vështirë ti gesh burra të fjalës edhe besës, sepse vërtet dalin tradhtar dhe rrallë kush është besnik e mburojë për shokun, mikun, dashamirin e të tjera; "FALJA E GJAKUT", lum si ai që fal se realiteti i familjeve shqiptare në kohën e sotëm e sa familje janë të ngujuar, dhe kjo është një thirrje për të gjithë këto raste, trim i mirë është ai që fal edhe duhet me fal, sepse falja dhe paqja është mirësia për çdo familje shqiptare.

Përveç gjithë këtyre fjalëve të shkruar në gazetën "Dukagjini" fal mirënjohjes dhe mbështetjes të veçantë që tregon zoti

RRUGA E NJË ARTISTI!

I suksesshëm edhe në Londër, artisti matjane, zoti Ikli Punavija

Shpesh herë jeta e vrullshme të bën të ecësh po aq vrullshëm mbase më shpejt se fuqia që na dhuron Zoti! E tillë është dhe veprimtaria artistike e Ikli Punavisë! Një sfidë që me hapat e parë në një moshë të brishtë dhe një rrugë plot pengesa, ca egoistë dhe ca burokratikë të pushtetit vendor nëpër kohëra të ndryshme!

Që në hapat e parë të veprimtarisë së tij ai shfaqet me universalitet artistik duke interpretuar me tre instrumente njëherazi në skenë (çifteli, fyell dhe lauri), gjë të cilën do ta kishte zili çdo artist me përvojë! Dhe kur mendon këtë interpretim krejt natyrshëm nga një fëmijë sigurisht të krijohet bindja që rruga drejt sukseseve është e admirueshme! Dhe kështu ndodhi dhe me Ikli Punavinë!

Në një moshë fare të re u ngjit në skena festivalesh brenda dhe jashtë Shqipërisë! Erdhën njëra pas tjetres çmimet dhe mirënjohjet vlerësuese për këtë artist të lindur! Ishin tre vite të mbushur me veprimtari të suksesshme si President i Shoqatës "Talentet e Reja Ahmet Zogu" në Mat!

Talentin e tij e shpalosi dhe në orkestren e Ansambilit "MATI"

Me këmbënguljen dhe punën e tij të palodhur Ikli Punavija ngriti nga hiçi grupin e ri folklorik "Grupin Folklorik "Petalba" Bashkia Klos, i cili kaloi kufijtë e Klosit, Matit dhe Shqipërisë! Organizojnë Klos dy festivale folklorike mbarë kombëtare, duke marrë pjesë dhjetëra grupe folklorike nga të gjithë trojet amtare, me mbi 200 artistë! Një ndihmë të çmuar mori dhe nga ish- kryetari Bashkisë Klos z. Basir Çupa, dhe kryetari Klubit Letrar "Pjetër Budi" Mat, zoti Hamdi Hysuka! Me ndërrimin e pushteteve u zbeh dhe ndihma për këtë grup folklorik!

Duke parë këto vështirësi që u krijuan Ikli dha dorëheqjen dhe mori rrugën e vështirë të emigrimit! Dhe Këtu ja doli falë këmbënguljes dhe vullnetit të tij! Më gjithë vështirësitë e të qenit emigrant

Ndue Sanaj dhe e gjithë redaksia i kësaj gazete për artistët edhe kontribuuesit e veçantë në fusha të ndryshme, që na krijojnë mundësitë për të shpalosur vlerat e çdo njeriu që ka një veprimtari të pasur siç është edhe rasti i prof. Mr. Blerim Gashi nga Prizreni.

Drama të tilla, me domethënie të ndryshme priten edhe në vijimësi nga ky grup aktrimi që luajnë aq bukur dhe vërtet na japin emocion në ngjarjet që shpalosin, duke lënë gjurmë në historinë e kombit shqiptar.

Me respekt dhe mirënjohje!

Ikli Punavija,

Kryetari i Ansambilit Folklorik Burimor Mbarkombëtar, Londër 10 shkurt 2023

prapë nuk heq dorë nga arti i folklorit!

Me ndihmën e miqve gjen mundësinë të luaj meloditë e bukura popullore me çifteli, lauri, fyell dhe bilbil, vazhdon të jetë aktiv në rrjetet sociale dhe media radio televizive!

Te radio "EKLIPSI" dhe te Televizioni "ALBUK TV", në Londër! Ku, nëpërmjet dy intervistave shpalosi gjithë veprimtarinë e tij artistike dhe shpresat për të ardhmen!



Autori matjan emigrantë në Londër, Xhavit Gasa dhe artisti matjan Ikli Punavija

Tani artisti matjan Ikli Punavija është kryetar i Ansambilit Folklorik Burimor Mbarëkombëtar në Republikën e Kosovës themeluar që me datën 20 janar 2020, dhe në këtë ansambël bëjnë pjesë dhe Grupi Folklorik "Besa Shosh", Dukagjini i Shkodrës, drejtuar nga rapsodi Ndoc Fusha, Ansamble dhe Shoqëri të ndryshme folklorike nga mbarë trojet shqiptare.

I urojmë suksese këtij artisti të njohur në mbarë trevat shqiptare si instrumentist, artist dhe drejtues i mirëfilltë, për të gjithë ata që e njohin nga afër Ikli Punavinë.

Është fare pak ky artikull i shkurtër për të shpalosur veprimtarinë e Ikli Punavisë!

Xhavit Gasa,
Londër 10 Shkurt 2023



Grupi i aktorëve interpretues

Zojë Mustafja - Burrnesha e Dukagjinit

Shumë shkrime, këngë, vjersha dhe studime janë bërë për Dukagjinin, por asnjëherë nuk ju vjen fundi shkrimeve, pasi kjo zonë ka aq shumë vlera historike sa që do duhen vite e vite për ta studiuar holësisht ketë treve legjendare të Shqipërisë.

Ndryshe nga shumë shkrimtare të tjerë, të cilët shkruajnë dhe përsërisin gjithmonë të njëjtat fjale rreth një heroi apo luftëtari, unë desha të ndalem tek një figure shumë e rëndësishme dhe e veçantë për zonën tonë. Është fjala për Zoje Mustafën, bashkëshorten e Mark Lulashit të fshatit Gurrë, të krahinës së Shoshit.

Po kush ishte Zojë Mustafja, për ata që nuk e njohin, për ata që kanë dëgjuar për te:


Zojë Mustafja lindi me 4 korrik 1895 në fshatin Theth, në kryeqytetin e Alpeve Shqiptare, në një fis mjaft të njohur dhe të nderuar nga i gjithë Dukagjini. Ajo kishte fatin të ishte nga dera e trimit Pjeter Gjoka.

Zoja u martua në krahinën e Shoshit, në fshatin Gurre me Mark Lulashin. Marku, ishte një nder burrat e zgjedhur të krahinës së Shoshit, i cili ishte një njohës shumë i mirë i ligjeve tradicionale kanunore. Marku nder vite mori pjesë në shumë e shumë pleqni të ndryshme në krahinën e Shoshit dhe jashtë saj. Thonë, se ishte shumë i prere në atë që fliste, por mbi të gjitha jashtëzakonisht i drejtë. Mark Lulashi ishte një burrë i gjatë, serioz, punëtorë dhe me kapital në kohën e tij.

Mark Lulashi dhe Zojë Mustafja ishin çifti më perfekt, që Zoti mund të kurorëzonte. Pothuajse sikur i shoqi edhe Zoja, sikur Marku, bashkëshorti i saj, nga paraqitja kishte tiparet e një gruaje të rreptë, të ashpër dhe të egër, por ishte komplet e kundërta. Ajo ishte një grua e gjatë, pak e dobët, me tipare burrërore dhe shumë fisnike.

Zoja, ishte shumë e rrepte ndaj rregullave tradicionale të trevës së Du-

kagjinit. Por përveç këtyre, ajo kishte edhe një profesion apo më mirë, kishte një dhunti, me të cilën u bë mjaft e njohur për kohen, që ajo jetoj.



Zojë Guri - Mustafja 1895 - 1957

Zoja ishte vajtoe e veçantë.

Me talentin e saj, duke krijuar në çast vargje të jashtëzakonshme, Ajo do të arrinte shumë larg. Kishte një zë të lart, piskamë, kishte një mënyrë të vajtuarit tepër të veçantë. Me kalimin e kohës ajo do behej shumë e njohur në të gjithë Dukagjinin.

Ajo e filloj jetën bashkëshortore me vajtimit në Shosh, për të vijuar më pas në krahinën e Shalës, të Nikajve e të Mercurit; në fshatin e Kirit, të Thethit, të Toplanes e të Prekalit dhe kështu me radhë në të gjithë zonën e Dukagjinit mbare si edhe jashtë tij.

Në kohën që ajo jetoj, i takoj të përjetonte regjime të ndryshme shtetërore, por një nder ta ishte edhe sistemi komunist, në të cilin u dënua me heqje lirie. Në Du-

kagjin, në këtë sistem jo pak njerëz kishin ndryshuar, të kishin frike edhe nga njeri-tjetri, por kishte nga ata që nuk pranuan të nënshtroheshin këtij sistemi. Gruaja sokoleshë, Zojë Mastafja, do të prangosej siç prangosen trimat. Ngjarja e saj do të merrte përmasa edhe më të mëdha, duke qenë se ishte diçka shumë e radhë, që një grua të burgosej, pse vajtoj Lulash Gjeloshin, i cili kishte luftuar me armë në dorë kundër regjimit komunist, dhe tha vargje vajtimit kundër sistemit në fuqi.

Zoja beri disa kohë burg, por nuk u dënua, pasi asnjë prej atyre spiuneve gjakprishur nuk e mori guxim t'i dilte dëshmitarë në gjyq, duke menduar, se me shpifje nuk mund të dilte kundër sokoleshës Zojë Mustafes, se jeta e tij mund të ishte në rrezik.

Zoja doli nga burgu, jo e penduar për fjalët e saj në artin e vajtimit, por e betuar që kështu do të vijonte dhe në të ardhmen, në rastet e tjera të vajtimit. Pra, burgu nuk e mposhti burrnesën, ajo mbeti e tillë edhe pas daljes nga burgu. Pa asnjë frike apo hezitim ajo do vazhdonte rrugën e lenë përgjysmë, tashme edhe më e fortë.

Në pak rreshta, kjo ishte historia e një gruaje dukagjinase e cila dha shumë për Dukagjinin dhe do të mbetet e gjallë do të mbetet e pavdekshme deri sa të ekzistoj emri Dukagjin, thekson Nikolin Guri.

Nikolini, stërnipi i saj, na solli vargjet e vajtimit të Zojë Mustafes, për të cilat u burgos dhe janë pjesë e këtij shkrimi:

"Na ka ardhe një krajl pa emen / Gjysa mashkull e gjysa femer / Bash me dit se shkoj me kry / S'mund po la për pa e shfryu / Na u kan ba burrat si gratë / Kan lane flokët kan rrue mustakt / Kure ra dielli në Kodër Shnjergjit / U la me gjake kisha e Ipezhkvit / Kisha e ipezhkvit la me gjak / Tuj i rrah burrat n' dajak / Kjoftë e zeze o kjo parti / Si na i veshi nanat zije / Si na i kthej rejat në gjini / ..."

Zoja Mustafja kishte vajtuar edhe

kreshnikun e Dukagjinit, trimin Zef Micani. Nga mbesa e tij, Gjyste Çarku-Bici, kemi disa vargje:

"Zef Micanit ça me i than / Nan ket bli, në ket lam / Kryq hell shpatullat e gjana / Von shoqin ja ban nana / Mallkue kjoshin bijat e Thethit / Mos e hjekshin brezin për-mjetit / Mos i hjekshin unazat gishtit / Me i majt jazin kti burri / ..."

Ndërsa kantautori i madh Mhill Çuni Gjonaj, në një këngë të tij do këndonte këto vargje për Zojë Mustafën:

"I madhi Zot ja past thy qafen / Kush burgosi Zojë Mustafën / Krajl as mret nuk e pat nal / Me kjajt trima n' Shosh e n' Shale / ..."

Stërnipi i saj, Nikolin Guri, thekson: E ndjeje për detyrë të shkruaj dy vargje për ketë grua heroin, por njëkohësisht edhe si trashëgues në fushën e krijimtarisë, talent apo dhunti që trashëgohet në familjen tonë, që nga koha e Zojë Mustafes:

"Dukagjin shumë për ty shkrova / tan heroit në këngë ti këndova / ju kam këndua trimave tu / që dhanë jetën tuj luftua / me mbrojt fe, me mbrojt tradita / me mbrojt trojet prej pushtimit / qysh në koh t' Lek Dukagjinit / Ju kam këndua trimave t' motit / Mehmet Shpendit, Lulash Gjeloshit, Ndok Gjelohe e Ndue Deli / Marash Tucit e Qerim Delise / Kol Mark Kola dhe Mark Lula / njaj Pal Gjoka burrë nder burra / e shumë tjerë burra me radhë / që kurrë kënga për ta s'ndal / Por këto male dhe këta shkrepë / paskan rritë dhe sokolesha / gra malësore me xhubleta / fort punëtore porsibleta / me u pas hije punëtoria / me u krenua me to malësi / Këto malësore sokolesha / i kanë rrit trimat në djepa / tuj u këndua kënga për trimni / tuj u thanë shumë histori / tuj u këndua me za bilbilit / historitë e Dukagjinit / ..."

"Një burrneshe pat rrit malësia / ja ndigjoi zanin Shqipnia / si një trim që ban trimni / ëmën la në histori / Zojë Mustafja kësaj i thonë / grua me famë për malësinë tonë"

(vijon nga faqa 11)
kjo është paga
e gabimit tejet të vjetër.
E ti,
Qengji i panjollë.
E ti,
qengji i pastruar
që për kul kokën
i druajtur dhe i butë,
qengji i flijimit,
që për asgjë nuk çirresh,
asnjë ankesë.
Megjithatë një tingull,
vazhdon një fllad
pushim për
fushat tona të thata
në këto netë vaji.
Në emër të Tij,
të Atij që na ka paraprirë,
e kryqëzuar,
e varur në dy trerë.
Në emër të Atit
u bëftë vullneti i Tij!

Një intuitë personale:
si një pistë e paeksploruar

Ndërsa kriminologët dalin në përfundimin se duhet përjashtuar që vrasësi i Lidia-s të jetë njëkohësisht edhe autori i poezisë, sipas reflektimit tim personal, mund të përfundohet edhe e kundërta.

Vërtet poezia ka ngjyra besimi të sakta, u përmbahet rregullave të lëvizjes fetare ku bënte pjesë vajza dhe vrasësi që hipotizohet, por rreshtat e parë sidomos, madje e gjithë poezia, lënë të nënkuptohet se ka gjasë se autori i vrasjes dhe njëkohësisht i poezisë, mund të identifikohet me vdekjen (sipas përshkrimit të tij), pasi ai është besimtar dhe është krejtësisht i penduar për ngjarjen makabre që mund ta ketë shkaktuar. I bindur për disa vlera të besimit të tij, e në shenjë pendimi, për krimin që mund të ketë kryer, shkakun e të cilit nuk mund ta dimë, mund të hipotizohet edhe fakti se autori i kriminit e ka përshkruar flijimin e pafajshëm të vajzës duke dashur ta sublimojë atë në nivelet më të larta. E nga ana tjetër, kur flet për gabim të vjetër, për britma, për vdekje, për luftën e përherëshme, duket sikur po paraqet atë që po ndodh në shpirtin e tij: ndoshta është një intuitë e guximshme, por au-

tori i vrasjes, i brejtur nga ndërgjegjja për gjestin e rëndë e të pakthyeshem, e duke e konsideruar veten si një Judë të historisë, duke mos guxuar që të marrë pjesë fizikisht viktimës, ia del kështu të marrë pjesë me mendimin e tij duke e shprehur ashtu siç e ndien dhe duke ia dërguar familjes në mënyrë anonime. Me këtë gjest, duke futur në fushë elemente të besimit dhe të riparimit, ka dashur autori të gjejë fijen e artë të lumturisë së qenies njerëzore edhe në situatën më dramatike të ekzistencës: Pranimin. Pranimin e gabimit nga ana e tij, duke tentuar ta përfshijë në një plan më të madh të shpëtimit e ngjashme krejtësisht me atë të vdekjes së Jezusit që erdhi për shkak të tradhtimit nga ana e Judës; pranimin e pësimit nga ana e viktimës dhe nga ana e familjes, duke nxjerrë në pah vlerën e flijimit të pafajshëm pavarësisht mënyrës se si ka ndodhur. Nëse i përmbahemi kësaj hipoteze, sigurisht autori i poezisë, nëse realisht është edhe autor i vrasjes, ka ditur mjaft bukur ta mbulojë me vetëdije krimin e tij në mesin e rreshtave të poezisë, duke dëshiruar sigurisht t'i shpëtojë drejtësisë njerëzore, për

të përfunduar direkt në duart e drejtësisë hyjnore.

Edhe në zemrën e një besimtari sado të zjarrtë, mund të banojnë tundimi dhe fatkeqësisht, mëkati. Ky është kontrasti dhe misteri i jetës së çdo njeriu. Duket sikur autori nxjerr në pah se pranon ligjin: Dëshiroj të bëj të mirën e më vjen për dore e keqja!

Më duket se në këtë rast për mua është ndezur një intuitë, duke konsideruar edhe faktin që autori nuk është firmosur dhe nuk ka dashur të identifikohet si autor i poezisë së sipërpërmendur.

Familja Macchi vazhdon të kërkojë drejtësi, ndërkaq edhe hetimet e shtetit Italian kanë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme që të zbardhet ngjarja. Megjithatë, ndoshta do të mbetet një mister që kurrë nuk do të zbulohet, përveçse në botën e përtejme, ku sipas mësimit të Jezusit nga Nazareti, çdo gjë do të dalë në dritë.

Nikolin Sh. Lëmezhi

/ n' histori për mej mbet kohës / ish kush-rina e Pjeter Gjokes / lind në Theth, mar-tua n' Gurr t' Shoshit / me Mark Lulashin at burrë motit / çift i mirë dhe i komple-tuam / n' Dukagjin gjithkund t' nderuam / Zojë Mustafja kjo malësore / profesionin kishe vajtoje / gjithçka i ra neper malësi / tuj vajtua djemtë e ri / tuj vajtua trimat e luftës / që dhanë jetën para pushkës / tuj vajtua njerëz me nivel / që nga Shoshi deri në Shkrel / si kje natë apo kje ditë / vajto djalë e vajto çikë / vajto krerë e trima luftime, t' varun n' litar / si këngëtari n' festivale / zani saj piskamë nder male / mej lidh fjalët për bukuri / me t' ba vajin poezi / kurrë për fjalë n' gusht mos me ra / a thua n' letër t' shkruame i ka / ...".

Prelë Milani, shkrimtar, poet e publicist, shkruan:Zojë Mustafja bijë Thethit e shtëpisë së trimit Pjetër Gjoka e martuar në Shosh me Mark Lulashin e Gurrës; Cole Çunja bijë nga Gjelajt e Thethit e martuar në Lotoj më Zef Gjeloshin dhe Drane Gjeloshja bijë nga Lotajt e martuar në Brashtë të Shoshit me Dedë Mëhillin, kanë qenë një trio sinonim i hijeshisë, fisnikërisë dhe sensualitetit femëror, vajtoje të papërsëritshme deri më sot në malet e Dukagjinit.

Zojë Mustafën e ka përmendur me gjithë konsideratë mitologu i maleve shqiptare At' Benardin Palaj. Vajtimet e Zojë Mustafës dhe Katrinë Tomës së Bogës (gjyshja e Tinka Kurtit, e cila pranon se genin artistik e ka nga gjyshja) kanë mbete të shkruara në visaret e kulturës sonë. Vajtoret dhe vajtarët (si poet popullor) kanë qenë personat publik të rëndësishëm të shoqërisë patriarkale kudo në male. Fama e tyre kalonte kufijtë krahinorë, kur vajtonin mjeshtërisht burrat zëmëdhenj, në mortet e të cilëve merrnin pjesë Dukagjin, Malësia e Madhe, Mirdita, Malësia e Gjakovës e të tjera. Një gjame e tillë e përmendur ku morën pjesë nga gjitha malet shqiptare ka qenë gjëma e Vat Dashit të Thethit. Zojë Mustafja, Cole Çunja dhe Drane Gjeloshja kanë vajtuar në mënyrë brilante burrat më të famshëm të Dukagjinit, si Lush Prelën (Bajraktarin e Shalës) së bashku me të dy djemtë të vranë nga Naçallniku, Abdi Kolën (Kryepresin e Gimajve), Ndokë Gjeloshin, Babun Celin, Mark Milanin, Zef Delinë, Vas Kirin, Sadri Lukën, Ndokë Mirashin, Vuk-san Lekën e të tjerë e të tjerë. Vajtimi i Mehmet Shpendit, Çun Nikës e Marash Delisë është një perlë elegjiake fatmirësisht e dokumentuar nga At' Shtjefën Gjeçovi që mban datën, Theth, me 5 mars 1917 periudhë që me sa duket konçidon me qënjen e tij famullitar i Prekalit.

"Mehmet Shpend, Marash Deli / S' kanë pas shokët n' Shqipni / Shkun te krajli i Malit Zi / Kesh po pështojnë ketë famulli. / N' besë të vet i paska gri. / I ka çartë, kjoftë i zi / Kur janë çartë ata dai / t' gjitha malet janë ba hi / Raftu zana, raftu pika / Gjithë shqipninë e preu thika / Çarti gra e çarti çika"

Kryetarja e Shoqatës kulturore "Xhubleta e Alpeve Shqiptare", në pikëpamjen e saj, paraqitjes së saj, me xhubletë të Zojës, shkruan: Një foto akoma më e qartë e

malësore Zojë Mustafja, në të cilën shihen veçoritë e tipologjisë së xhubletës së Dukagjinit.

-Luku me flokë të valëzuar që mbulojnë ballin tipike e kësaj treve, ku theksohen vetullat dhe i jepet liri t'pamit.

-Pështjellaku me punime simetrike me zgjatime vertikale.

-Grykolja e zbukuruar me lulet e sermit të xhubletës.

-Brezi me punim tertili me simbolin e jetës.

-Vierrcat e supeve me boçë e me thekë, që simbolizojnë litat, frytet e Lises së Shenjtë.

-Groshatar me një të veçante tipike e malësoreve katolike në moshë.

Diçka e veçantë, Ndue Sanaj: Zojë Mustafën nuk e kam njohur, por që në moshë të re kisha dëgjuar për te. Por, me 13 shkurt 1973, isha me Kolë Pjetrushin, djalin e Pjeter Mirashit të Gjurajve, ai veshur me uniformen e rezervistit, ndërsa unë me uniformen e oficerit. Pasi hëngrëm dreke në shtëpinë e Pjeter Rrokut, në Kir, stërnip i shtëpisë sonë, u nisem për në fshatin Ndreaj, qendër e krahinës së Shoshitj e pastaj me dale ne Breg-Lumi. Kur dolëm në malin e Shoshit, binte bore e frynte shumë ere, sa të merrte frymën. Ishte tufan. Filloi të errej dhe po humbisnim edhe rrugën. Nuk mund të themi se mund të mbesnim në borë, po sikur të mbesnim, do të na bënin dhe të ditur ...

-I drejtohem Kolës: - Kolë a këna kund shtëpi afër, se kështu nuk mund të shkojmë as në Ndreaj, jo më në Breg-Lumi jo se jo?!

-Kola, më tha: - Po, por nuk e di se si janë nga ana politike!

-Kolë, i them, vetëm na prijë, se për ketë punë nuk të thotë kush gjë, përgjigjem vete ...

Kola na prini dhe kur u afruam disa shtëpive, njëriës i thirri: - O, i Zoti i shtëpisë!

Ishte një dhomë e madhe, me votër dhe në njërin anë ishte një burrë i vjetër i sh-trime në një post, ndera në anën tjetër të votrës ishte një djep, që e përkundte një grua e moshuar ...

I kemi dhanë dorën plakut, por ai nuk u ngrit nga posti, i dhamë dorën gruas dhe djali na pruni dy stola e u ulem ...

Djali na solli kafe, ujë me la këmbët dhe kaloi gati një gjysme ore dhe as kush nuk bënte bisede me ne!

- I them Kolës, na duhet me nis bisedën, se kështu nuk kalohet, ndoshta kujtojnë se jemi prej Jugut, se Jugu shquhej për ushtarake (Oficer) dhe kushedi se në gjendje i kemi gjetur.

-Kola me tha mirë.

I drejtohem burrit të moshuar, të sh-trime në post:

-Bacë, mos u shqetësoni për ne, se dhe ne jemi dukagjinasi si edhe ju!

Plaku me njëherë lëvizti nga posti e u ngrit me gjysmën e trupit dhe me pyeti:

-Nga cili vend?

-Gjuraj, i them.

-Plaku u ngrit në njërin gju e më tha: - Po, i kujt?

I thash vetes, ku i njeh ky prindërit e mi dhe i them:

-Jam nipi i Zef Kolës (gjyshi im) dhe stërnipi i Gjon Prekës (daja i babës).

-Plaku më thotë, - po i cilit?

Atëherë e kuptova se diçka më afër duhet të jemi, për deri sa më thotë, i cilit.

-I them, se jam djali i Dodes.

Po sa i thashë se jam djali i Dodes, më merre ngrykë dhe aq fortë më shtrëngonte, sa i thashë vetes, ku e mori gjithë ketë forcë Plaku?!

Po sa filloi Plaku të me tregoi diçka, i tha djali: - Babë dhoma gati!

U ngritëm e ecëm pas Plakut e hymë në dhomë. Dhoma e madhe 5 x 6 m, me oxhak dhe në oxhak zjarrmi ishte i plotë, dyshemeja e shtrueme me rrogos e mbi te ishin shtrua qilima dhe pa u ulur na sollën rroba të ndërrohemi, se ishim të lagur plotësisht.

kaq, por ai ishte probatini i gjyshit tim, i Zef Kole Sanit.

Marku filloi të më tregonte:

-Ishte viti 1930, ditën e Shna Ndout të dimrit, se fshati Plan e Gjuraj festoni si fshat natën e Shna Ndout të dimrit. Pra, ishte date 17 janar i vitit 1930. Në atë dreke feste ishim plote, mbi 50 vete. Zef, po të thuash rrinte në këmbë, sa te një trevezë te tjetra trevezë dhe duke ju krijuar miqve një atmosfere shumë të dashtun.

Në ketë kohë, njeri prej nesh i thotë Zefit: - Zefa, kam ardhur me qellim të caktuam, në ketë ditë të madhe, për të pi gjakun me ty e për tu ba probatina bashkë!

Pa marre përgjigjen nga Zefi, ja pret një tjetër: - Edhe unë Zef Kola kam ardhur me qellim të caktuam, për të pi gjakun me ty dhe për tu ba probatina!

Zefin, po baj sikur po e shoh i tash, që bani buzën në gaz dhe pastaj ju tha:

-Ju dashamir, Zoti ju bekoftë e ju paça gjithmonë në të mira, por i kam dy probatina dhe nuk kam qefte të bahem dhe me një apo dy të tjerë. Ju jeni mjaft të mirë e Zoti ju ruajt e ju bekoftë dhe shpija ju paste, por dy që kam i kam për qejfte dhe nuk dua t'i përziej. Besoj se më kuptoni!?

-Atëherë, tha Marku, nuk e di, se si më erdhi aty për aty, pa e pas në mend më pare, isha shumë i ri, por jam ngrit në kambe dhe i kam thane: - Zef Kola, pasha një ketë nate të madhe, mua nuk mund të më kthesh dhe i jam afrua e u ngjita me te.

-Atëherë unë, na tha Marku, isha 18 vjeç, krejt djalë i ri dhe po të thuash ishte hera e parë, që merrja pjesë në një festë të tille dhe me një pjesëmarrje kaq të madhe ...

-Zefi më tha: - O djali i Gurrës së Shoshit, si kam me të kthye ty mbrapshte, se mua më duhet një djalë i ri, që ta kem gjithnjë në ndihme me vete.

Atëherë na prunë një gjylpane, dy kupa të vogla rakië, shpuam gishtin tregues ai e unë, kulluam gjakun në kupën e njeri-tjetrit, që ishin me raki dhe e pimë, u përqaftuam dhe u çuan kupat e rakisë me fund dhe u ba një urra e fortë nga pjesëmarrësit, duke na urua: Kurrë Zoti mos e ndalte dëshninë e njeri-tjetrit. Kështu, unë jam probatini i gjyshit tanë, më tha Marku.

Jam çua në këmbë dhe e kam marre gryke Markun dhe i kam thane: Të jam fal Probo! Të betohem, që sa të jem djemve, nipave e stërnipave të tu, kam me i thirre vetëm Probo.

Ky ishte takimi i parë, njohja e parë me ketë burrë kaq fisnik dhe i thashë vetes: Gjyshi i jem i paska ra "pikës" dhe i lumtë! Por, koha bani punën e vetë dhe nuk pata rastin të takohemi më me ketë burrë mjaft i kohës e fisnik. Vioj njohjen me stërnipin e tij, Nikolinin dhe sa here takohemi, apo shkëmbejmë mendime, i drejtohem "O Probo...!"

Mark Lulashi e Zojë Mustafja, me djemtë Gjergj e Kolë Mark Lulashi; vajzat Drane (Dranja-Nëna e kantautorit "Mjeshtër i Madh" Mhill Gjon Çuni) dhe Mri Mark Lulashi

Ndue Sanaj e Nikolin Guri



Familja e Mark Lulashit e Zojë Mustafes

Doli një djalë dhe na tha: Urdhëroni e mirë se ju ka pru Zoti!

Pasi u takuam me djalin, na prini bren-da në shtëpi ...

Pasi u ndërruam, vijua bisedën e lamë përgjysmë në kuzhine dhe Marku (atëherë i mësova dhe emrin) po më tregonte se si njihesh me familjen time dhe jo vetëm

NGATRRESË ME HATËRMBETJE...



TAHIR BEZHANI,
Gjakovë, me 3 janar 2023

Tregim

Muaj tetor kishte filluar me mot të mirë. Dielli rrezonte si në fillim pranverë. Të korrat dhe punët e verës kishin mbaruar, përgatiteshin tokat për të mbjellat vjeshtore. Qëndrim Bregu interesohet për çdo imtësi të punëve shtëpiake; për farën, për plehun, traktorin, drutë për dimër, veshmbathjen e të tjera. Madje ndihej më i obliguar nga të tjerët, me që ishte edhe zot shtëpie në mesin e dhjetë anëtareve të familjes Bregu.

Kishte kohë që punët e tepërta kishin filluar ta lodhnin, por durimin e gjente në thembër të këmbës. E donte mjaft vëllain, Granitin, sepse kishte kultivuar disa tipare të rralla njerëzore, bazuar në traditën dhe edukatën e familjes Bregu. Por kohëve të fundit, në vitet e pasluftës e kishte përfshirë njëllor vetëmburrje, krenarie e pa arsye fare Granitin, sa që të tjerët i dukeshin shpeshherë si miza....

Këto sjellje e vrisnin Qëndrimin, nuk i dëshironte. E donte mirëkuptimin, besimin, punën dhe shkollimin e fëmijëve të tyre. Shpesh i thoshte vetes “e pse vuarjtëm, luftuam, u dogjëm e u përvëluam, vetëm për të pasur të mirat e lirisë në tokën tonë!...”

Koha kalonte si uji nën urë. Punët brenda familjes bëheshin gjithnjë e më të rënda, shtoheshin kërkesa të reja për jetën, nga se fëmijët rriteshin si fieri në pranverë. Qëndrimin kishin filluar ta përfshinin komplekset familjare. Vëllai Graniti, tanimë, kishte kaluar kohë që nuk e dëgjonte, nuk e përfillte thujat për asgjë në shtëpi, as familjen nuk e respektonte.

Iu kishte pleksur në kokën e tij një vetëmburrje e tepruar, e pa shpjeguar. Qëndrim Bregun kishin filluar ta mundonin një mori mendimesh në qenien e tij. Shpesh netët i kalonte pa gjumë, duke menduar se si të zgjidhë problemin me Granitin, ta rikthejë në interesin familjar. Mendonte, mendonte e vetëm mendonte gjatë....

Një natë vjeshte të vonë binte shi si konop. Vetonte e bubullonte sa oborri e rruga afër dukeshin si në flakë të verdhë. Të gjitha pemëve në kopsht u kishin rënë gjethet. Ullukët e shtëpisë me vështirësi e kapërdinin ujin e shiut. Në gjithë atë

lemeri moti, Graniti si një hajdut, natën hapi derën e oborrit, me çelës në dorë edhe atë të shtëpisë dhe u fut në odën e fjetjes, te familja e vet. Qëndrimi kur dëgjoi krismat e bravës, përgjoi dhe sa konstatoi se ishte vëllai, Graniti, u kthye në anën tjetër e në vend të gjumit, u ngatërrua me kohën e kthimit të Granitit në shtëpi, në ato orë të vona të natës. Filloi të djersitet. Drita e mëngjesit e zuri pa kokërr gjumi në sytë e tij. Me rëndim koke u ngjit në ditën e re, por edhe me mendime të reja. Do bisedoj me Granitin, nuk shkon tutje kështu. Kemi përgjegjësi të barabartë në familje, për fëmijët tanë e për shumë e shumë gjëra të tjera- pëshpëriti me veten.

Të nesërmen e priti gjatë derisa u zgjua Graniti nga gjumi. Gdhiu i dërmuar pa punuar asgjë. Qëndrimin i dridhej i tërë trupi, fytyra i skuqej, i sikletosur, fërkonte faqet me dy shuplakat e duarve. Kishte ardhur një moment që duhej të ndalej kjo “aventurë” e Granitit. E si nuk e di, iu druhej fjalëve të rënda, përkeqësim-it, nuk e dëshironte atë gjë me vëllain. Megjithatë, foli me veten Qëndrimi, këtë duhet bërë sot apo nesër. Më mirë sot se nesër, bëhet vonë!...

Kur hapi dritaren e odës, shikoi oborrin e mbushur me uji shiu. Retë e zeza kishin ikur qiellnajtës pafund. Dukeshin do rreze dielli vjeshte të vonshme, inspiruese. Shpatijeve vërehej një mozaik ngjyrash vjeshtore. Gjethet ishin gati t'i dorëzoheshin kohës vjeshtore. Përrenjtë ushtonin në atë qetësi mëngjesi, ia thoshin këngës memce si përherë. E la dritaren hapur për ajrosje, mbathi këpucët dhe shkoi te kuzhina.

Pa Granitin duke pirë kafënë e mëngjesit, hurbatke rrëmihshëm dhe tymoste një fitil duhani mes gishtërinjve të mavijosur nga nikotina.

-Mirëmëngjesi Granit! Të bëftë mirë kafeja!-

-Mirëmëngjesi. Faleminderit Bac- ia ktheu Graniti.

Të pres në odë pasi ta pish kafënë Granit, foli Qëndrimi dhe doli nga kuzhina.

Pasi u ulën ballë përballë njëri me tjetrin, bisedën e filloi ma i vjetri, Qëndrimi, me fjalët më të ëmbla që mund të nxirrte nga goja.

-Dëgjo Granit!-filloi bisedën Qëndrimi, ka kohë që punët nuk po na shkojnë mbarë në shtëpi. Ti ke ikur pak si larg nga përgjegjësitë familjare e shtëpiake. Gjithë kohën nuk e di se ku gjendesh e me kënd rrinë, natën kthehesh vonë. Nuk dinë asgjë gruaja e fëmijët e tua se ku je e çka po bën. Po sjell nervozë në familje Granit. Punët vetëm nuk po mund t'i kryej as unë. A e din ti se kur është mjaft, a do të veprosh ndryshe tash e mbas. Është koha t'i tregosh vëllait tënd, mua- e përfundoi bisedën Qëndrimi.

Graniti një kohë nuk e hapi gojën. Rrinte në heshtje. Mendonte. Analizonte mundësitë e punët e veta. Në ballë i dilnin rrudhat si thupra gardhi, herë tkurreshin e herë hapeshin. Do pulla djerse iu panë ballit. Një ofshamë i erdhi furishëm nga shpirti. Pëlciti si vullkan, një përgjigje flak për flake. I mërdhezur në fytyrë iu

drejtua vëllait, Qëndrimin, me këto fjalë:

-Bac, unë po e shoh se ty të kam lodhë, edhe familjen. Unë marr pension invalidi nga lufta, rri me luftëtarë, jam anëtar i një partie politike, kaloj kohën me ta, rrimë deri vonë. Ti bën si të duash; duro ose mos duro, puna jote është. Unë punë fushe ma nuk punoj, kot e ke. Ti tani vepro si te duash, vetëm grithë në llashtë, nëse vazhdon bisedën me lutje tjera, përfundoi Graniti.

Qëndrimin sikur iu soll e tërë dhoma rrotull. Sikur pa një ëndërr të keqe. Nuk donte t'i u besonte as syve e as veshëve se çfarë dëgjoi nga Graniti.

Granit,-tha Qëndrimi, nuk i prita këto fjalë nga ti. Mendova se do jesh më i mirësllëshëm ndaj meje dhe familjes në tërësi. Kështu nuk shkon matej. A ke mendim tjetër më të mirë për familjen tonë apo?!

-Bac, mos më lodh më tepër, të thashë, mos grith në llashtë-e përfundoi Graniti përgjigjen.

-Ehu Granit çka fole! Mirë. Deri këtu e paska pasur. Doli e i ftoi dy axhallarët dhe sipas kanunit, e ndau gjithë pasurinë me Granitin. Gjate ndarjes lakmia e drejtonte Granitin shpesh edhe në fjalët e rënda e nënçmuese ndaj Qëndrimin. Madje, shpesh axhët e tyre i thoshin “mos se është marre, Qëndrimi është më i vjetër e mundimtar i shtëpisë!...”

Pas gjashtë orësh, me prezencën e dy axhëve, Qëndrimi e Graniti, dolën në tymrat e shtëpive të tyre. Ndan shtëpinë, tokën, gjanë, gjitha trentë e shtëpisë, edhe pulat e dy këlyshë të vegjël, pese javësh. Ndanë gjithë pasurinë e babës dhe atë që kishin fituar vet, por megjithatë, “syri i unët” i la ftofshëm mes veti dhe mjaft të tensionuar. Madje pas ndarjes, brenda pak ditësh, Graniti bëri edhe murin mes oborrit. Nuk kishte durim ta shihte vëllain në oborrin e tij. Në familje ishte si mort zie. U mërzhiten e gjithë familja, fëmija dhe granimi. Fëmijët kishin lumturinë e tyre, lodrat e përbashkëta, tërvezen, shkollën, kujtimet, ruajtjen e bagëtisë dhe nuk ua pranonte logjika atë ndarje. E mendojshin të pakapshme dhe pse-ja, nuk kishte përgjigje deri në rritjen e tyre....

Pas ndarjes së familjes Bregu, ditët ecnin me hapa të rëndë. Asaj vjeshte të vonë vetëm zërin ia dëgjonin njëri tjetrit odave të ndara me mure dhe oborreve me mure kinës mes njëri tjetrit. Nuk flisnin e as nuk takoheshin mes veti, as ne rrugë, as në qytet. Edhe kulmin e kishte kapluar një zymtësi e paarsyeshme. Ishin mësuar me zhurmën e fëmijëve, lojën dhe hallakatmënin e familjes në rritje. Tani, kjo cektësi e vriste dalngadal, si helmi, Qëndrim Bregun. Ishte ofruar viti i ri, stina e dimrit, ku netët janë më të gjata dhe më të hareshme, si dikur kur kalohej shpejt me lloj lloj lojnash dhe miq e miqësi.

Ishte ofruar pranvera. Kishte kaluar gjysma e shkurtit. Nuk vëreheshin lara bore as luginave, as stomeve të arave e gardhishteve. Mbase, disa kishin filluar të pastronin oborret, të bënë gati ndon-

jë lehë për mbjellje qepësh të hershme. Tagjia për kafshë ishte në sosje. Shiheshin disa podina me sanë e jonxe që duhej gratuar gjithsesi deri në behar të rij.

Në syrin e asaj pranverë, ditë me diell, por diell me dhëmbë, frynte veri i ashpër, Qëndrim Bregu kishte pirë kafënë e mëngjesit në odën e burrave, në katin e dytë të shtëpisë, vetëm. Vetë e kishte pjekë kafënë në furnele dhe gjithnjë duke parafytyruar se si i pinin së bashku me Granitin kafetë e mëngjesit. Pas kafesë, u zhyt në mendime se si do ta kalonte ditën, me çka do merrej, derisa ende flinin fëmijët. Ishte e diell, ditë pushimi, nuk i trazoi, i la të ngopen gjumë. Janë të rinj-tha me vete. Pa dashur iu kujtua ndarja me vëllain, Granitin. E gjithë ngjarja i rrëshqiti si një shirit filmi para syve. E mendoj fundin e vjeshtës, gati gjithë dimrin pa u parë, takuar e biseduar me njëri tjetrin.

Si i thonë kësaj pune-foli me veten. A shkon jeta me kaq prishaqeflek, kaq zi. Ku ka ma zi se, mos të flasësh me vëlla! As axhët e as miqtë nuk i dëgjoi Graniti, madje që të hyjmë te njëri tjetri. Gratë tona nuk patën asnjë faj. Mana e Hana kurrë nuk u grinden mes veti. Fëmijët duheshin shumë. Çka e zezë krisi mes nesh. Bota është shumëzuar me ndarje, nuk jemi rrahë e as sharë. Pse nuk vjen ai, është më i ri se unë...

Ishin këto mendime që bluante. Qëndrim Bregun e mbushnin mërzitë të skajshme. I tretur në gjithë horizontin e mendimeve të raskapitura, instinktivisht u ngrit në këmbë dhe po ecte mendueshëm nëpër dhomë. Gjithë atë zhytje në pellgun e errët të mërzisë, mendimet ia trazoi një lehje qeni, një cijatje këlyshi që i vinte andej, kah lama e sanëve, prapa shtëpisë. Nxitoi si me kureshtje për ta parë e dëgjuar atë zhurmë mëngjesore. Hapi dritaren dhe pa se si këlyshi që i kishte ra Qëndrimin, kishte hipur në podinën e sanës dhe sulej andej, kah vëllai andej murit, kah Graniti.

Që të dytë sulleshin, bënë turrë nga një tjetri, duke artikuluar disa cijama malli. Përpëliteshin me mundim murit për të dalë te njëri tjetri. Të dy këlyshët “qajshin” përmes cijamash me mallin për t'u takuar. Ky gjest kafshor ia shprushi të gjitha ndjesitë, i krijoi emocione të papara Qëndrim Bregut, duke e detyruar deri në lotim. Përsëri i erdhi si një shirit filmi ndarja dhe arsytet e ndarjes. Përpiquej të gjente arsytet, shkaqet dhe pasojat e gjithë asaj çfarë kishte ngjarë mes Qëndrimin e Graniti, dy vëllezër të dashur e të respektuar, jo në fshatin e tyre, por në tërë trevën që i rrethonte. Shpesh i shkonte mendja te ndonjë person, nxitës nëpër fshatra, që ngatërronë familjet e ndershme, se a mos kishin ndikuar tek vëllai, Graniti, për gjithë atë hidhërim mes tyre. Assesi nuk iu shkoqte mendja ndaj Mustafë Dallaverit, një person i njohur për keqësimet e familjeve në fshat e jo vetëm, se a mos ishte personi kyç i asaj pamirësie. Por frenoi mendjen, derisa nuk kam fakte, duhet të heshti dhe të gjejë rrugë të tjera, i tha vetës Qëndrim Bregu, shumë i përmallur për Granitin. Me t'u

kthyer në odë, sapo u shtri, i shkuan lotët skurrjalë nga malli. Me cepin e shamisë fshiu faqet dhe u përplas i përmalluar në ballë të oxhakut, i menduar thellë.

Në ato çaste u hap dera e odës së burrave dhe në dhomë hyri bashkëshortja, Mana, duke e përshëndetur Qëndrimin dhe duke e lutur për kafe ose mëngjes, si zakonisht. Kur e vërejtë mirë në sy, hetoi se diçka nuk ishte në rregull me bashkëshortin, Qëndrimin. Lehtas, përlësisht iu ofrua dhe e pyeti me fjalë që me zor dëgjohehin: "Qëndrim, çfarë ke? Me dukesh nuk je mirë! Si mund të të ndihmoj, çfarë do? Mos të shohin fëmijët kaq të lodhur, i frikëson! Mos, Qëndrim, zgjohu! Fol, si të ndihmoj? Ta bëj gati mëngjesin, a ke kohë?"

Si i zënë pisk nga bashkëshortja Mana, dhe, i shtrënguar nga trazimi shpirtëror për "largimin" e vëllait nga vetja pa asnjë

arsye, iu drejtua Manës:

"Ulu grua para meje. Nuk kam me kënd të bisedoj për punët tona. Baba më la, vëllai u nda nga unë, le me pasuri, se këtë e bën gjithë bota, por po më rrinë larg edhe shpirtërisht. Nuk kam folur me të që gati pesë muaj. Malli më ka marrë të ndërroj dy fjalë. Dëgjo grua, sot kam parë çudinë e Zotit!. Kafsha kishte më mëshirë se njeriu, ma shumë dashuri e humanizëm. Nuk e kam ditur, as nuk e kisha besuar kurrë! Sot pashë me sytë e mi se çfarë bënë dy këlyshë kundre pas njëri tjetrit..."

Ia trego ngjarjen Manës në tërësi dhe filluan lotët t'i zbresin mollëzave të faqes. Prandaj, këtë "mësim" nga kafshët, dua ta zbatoj që sot. Pasi të ha pakës mëngjes, dua t'i futem brenda vëllait dhe ta rroki me përfaqim pafund. Nuk mundem ma! Po kallem nga malli. Nuk pres askënd të

më rregullojë me vëllain që më ka lindur nëna.

Pas mëngjesit, nuk vonoi shumë, Qëndrim Bregu ndërroi rrobat dhe mori sheqerka për të fëmijët e vëllait, doli për dere të oborrit dhe, ktheu djathtas në derën e Granit Bregut, vëllait më të vogël. Në derën e shtëpisë së Granitit u dëgjua tri krisma gishtash në derë. Nga jashtë u dëgjua një zë gruaje:

"Del Granit, dikush po troket në derë!..." - ishte urdhri i Hanës.

-A jeni këtu o Granit Bregu? - jehoi zëri i Qëndrim Bregut në derën e hyrjes në shtëpi!...

-Po, po, këtu jemi o vëlla e mirëserdhe! - dhe shtrëngimet ishin të gjata, të përcjellë me lot malli për kohën që kishte kaluar pa u takuar. Si dukej, Graniti ishte penduar për sjelljet e tij. Duke vrapuar dolën nga dhoma edhe fëmijët e Granitit

e bashkëshortja Hana, të gjithë duke e shtrënguar fort Qëndrim Bregun. Fëmijët i folën me zë prekës:

"A xhë na ka marrë malli shumë për ty! Si është inxhia Manë e të tjerët?"

Eeeee!.. Gani Bregu- filloi bisedën Qëndrimi, duke ofsha thellë. Në kohët e sotme, nuk na vlejnë hidhërimet mes njëri-tjetrit, por mirëkuptimet. Nuk kalon jeta pa njeri tjetrin. Ndarjen mes vëllezërve e ka lanë Zoti, kështu është shumëar dynjaja, por dashurinë e respektin, mirësinë e bamirësinë nuk duhet hequr nga zemra e mendja e as nga shpirti. Këtë gjest të mirëfilltë e kishin edhe kafshët, e he-tova të këlyshët tanë. Tani, Granit, jepu "lirinë" të takohen fëmijët e kunatat, i ka marrë malli të gjithë për njëri tjetrin!

Kështu e ka jeta, me sfida e shumë rëndime të tjera, por së bashku përballohen më lehtë...

*** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI ***

JANË SHQIPTARËT PËR TY SHQIPËRI!

Shqipëri, o Nënë e shenjtë,
n' historinë tënde të rrallë.
Do të jem unë bir i denjë,
do të jem një gur i gjallë.

Ti je Nënë gjithmonë me nder,
ti je toka e larë me gjak.
E pamposhtur ti si përherë,
nuk u trembe kurrë aspak.

Ndaj gjithmonë ty plot dashuri
do të këndoj në tokën mbarë:
Nëna ime, je, o Shqipëri,
sot falë teje jam shqiptar.

S'do të pres, pra, nga ndonjë tjetër,
të vërë dorë mbi këtë ndërtesë.
Tokë hyjnore, kaq e vjetër,
po ta jap sot këtë besë.

Sa t'jen' dielli edhe hëna,
sa të jetojë kjo njerëzi.
Sa t'ketë bij edhe nëna,
janë shqiptarët për ty Shqipëri!

*Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, më 28. 02. 2023*

E TANI Ç'TË BËJË KAQ VONË...

Nuk di ç'të bëjë n 'këto çaste të vona nate
Kur dhimbja shtrihet gjatë skutave të shpirtit
E lotët mbesin të hutuar bebëzave,
Lidhur kujtimeve nëpër kohë
Ëndrrave të natës u vjen era plagë
Se ke ikë, n'pakthim zemër e shkretë
Vetëm kujtimet mbajnë lotët si n 'epurutetë

Udhëtoj gjurmëve të mbetura rrugëve tona
Hijet përfaqohen kudo ndodhjeve të djegur
Dëgjoj ofshamat tua e dëneset lotuese ndarjeve

Kuturisjet si rrjet merimange floknajës bardh e zi
E zjarrin e mbajë të ndezur si natën e gjatë të dimrit
Kudo që ishim hiri dëshmon si përmendore
E gjithë ky udhëtim prushnajës këtë natë të zezë
Më kafshon si dhimbje pa ngushëllim
Pajtimi do ishte mrekulli e prituri
Sikur të ishim ndarë n'përfaqim
Para Zotit do ishim të pastër, u dashtëm aq shumë!...

Tani e din edhe loti se ka mbetur i tkurrur thellësive
Vetëm rrugëtim pa frenim dëshiron
Për të fundit herë të vij tek varri në përfaqim
Ta puthë atë lapidarë e dhe të zi
Vetëm pak sekonda jetë, sy me sy e lot me lot

E pate thënë
Te "Grandi" ishte takimi i lënë
Pragun e derës e patëm dëshmitar
Por koha na dogji në largësi
Kujtimet mbeten në vargje librash-dëshmi
Dashuria nuk vdes, nuk varroset
Dashuritë takohen mes vete ëndrrave
Dashuri e pasosur kurrë.....

Tetor, 2022

FRYMËZIM NATE ME HËNË

Në mesnatë
Në dritaren e dhomës së gjumit
Trokitën rrezet e hënës në vetullën time
Hap sytë, buzëqeshje e ngrirë n 'dritare
Dritë hëne e zverdhur shpateve shikoja
Dallgë gëzimesh ndrydhnin idhjet e ditës
Gurëzuar mes plasjeve shkëmbore
Freskia e natës miklonte poret e regjura
Ofshamat e helmuara lodrojnë shpateve
Melankolia tretet këngëve të heshtura
Si shpuza fluturuese e hirit n 'harresë
Xixëllon xixëllonja e fjalës syprinës qiellore
Pishat rrëshqanore përjargen n 'qetësi
Do vargje të urta përkundin ëndrrat e fjetura
Zgjohej trembshëm zogjtë e ngujimit
Zjarrishtës së përflakur, gjollave të ballit
Sodis hapësirën në dritare, yjet si vallëzojnë
Thith oksigjen të natës pa bëzajt
Pastaj rrëshqas thellësive të ditës së egër
Nuk futem brenda pa thënë hëna "ik!..."
Kërkoj gjilpërën n'kashtën e djegur
Rri në dritare duarkryq lidhur
Si në lutje Hyit në ditë festash
Pi avullin e ditës pritjeve të reja...

Tahir Bezhani, Gjakova



REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI
Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin:

**PETRIT SOKOLI,
Miçigan SHBA**

